

Strategjia për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për periudhën 2018-2021

Shkup
korrik 2018

Përmbajtja

Hyrje	4
1. Koncepti dhe metodologjia	5
1.1 Analiza e gjendjes	7
1.2 Definimi i prioritetëve, qëllimeve strategjike dhe masave	8
1.3 Ndjekja e statusit të zbatimit të Strategjisë dhe planit të aksionit	10
1.4 Pjesëmarrësit në proces	10
2. Pasqyra e aktiviteteve të realizuara më të rëndësishme	11
3. Gjendja ekzistuese në sektorin e sipërmarrësisë dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë dhe në Qytetin e Shkupit.....	13
3.1 Strategji dhe dokumente shtetërore të cilat e definojnë funksionimin e sipërmarrësisë dhe NVM në Maqedoni.....	14
3.2 Profili i NVM dhe sfidat	15
3.3 Sfidat kyçe me të cilat përballen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.....	16
3.4 Demografia e biznesit dhe dinamika e biznesit	17
3.5 Ndërmarrje aktive nëpër komuna.....	18
4. Përparësia konkurruese e Qytetit të Shkupit për zhvillimin e NVM dhe sipërmarrësi në raport me komunat e tjera.....	19
5. Parime të politikës mbështetëse.....	23
6. Vizioni, misioni dhe qëllimet strategjike.....	24
6.1 Vizioni i Strategjisë:	24
6.2 Misioni i Strategjisë	25
6.3 Qëllimet strategjike:.....	25
7. Qëllimet Strategjike	26
7.1 Ambianti i volitshëm afarist	26
7.2 Mësimi sipërmarrës dhe kultura sipërmarrëse	27
7.3 Inovacionet	28
7.4 Sektori produktiv dhe konkurrues i NVM (NVM produktive dhe inovative në tregun e vendit dhe pjesëmarrës konkurrues në tregjet e huaja)	29
7.5 Financimi	31
8. Implementimi, kontrolli, masat korrigjuese dhe revizioni i Strategjisë	33



Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



9. Plan i aksionit.....	34
Shtojca 1 – Pjesëmarrësit e procesit	82
Dispozita përfundimtare	84

Hyrje

Kushtet bashkëkohore të punës karakterizohen me ndryshime dinamike dhe strukturore, zhvillim të teknologjive, internacionalizim të bizneseve, konkurrencë të rritur globale, fragmentim të tregut, rritje të pasigurisë, me mungesë sigurie dhe me rrezik etj. Ata e iniciojnë nevojën e krijimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat me novatorizmin e vet, me kreativitetin e vet, me rritjen e vazhdueshme të produktivitetit dhe fleksibilitetit të vet, do t'u përgjigjen kushteve të reja të krijuara dhe dukshëm do t'i kontribuojnë zhvillimit të gjithmbarshëm shoqëror. Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) mundëson që të ndjehen efektet e tyre sa më shpejt në: punësim, rritjen e prodhimit, forcimin e konkurrencës, zhvillimin social dhe, përgjithësisht, në zhvillimin njerëzor.

Vetë proceset e globalizimit bëjnë një ambient i cili ndryshohet në mënyrë radikale dhe kështu bota bëhet një treg i madh ku tregjet nacionale, rajonale dhe lokale humbin nga rëndësia tradicionale.

Në çdo ekonomi dinamike, duke pasur parasysh ndryshimet e kushteve të ekonomizimit dhe mbisundimit të ligjshmërive të tregut, parakushti themelor i suksesit është funksionimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, që bëhen sektor dinamik, por në asnjë rast nuk duhet lënë anësh edhe roli i kompanive të mëdha për zhvillimin ekonomik, ngase ata edhe më tutje kanë efikasitet dhe produktivitet të lartë dhe ofertë të madhe për përvetësimin e tregjeve botërore.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me qëndrueshmërinë, vitalitetin dhe inventivitetin e vet, janë gjeneratorë të punësimeve të reja dhe mobilizues të të gjithë faktorëve të prodhimit. Ata bëhen gjithnjë e më atraktivë në shoqërinë globale prandaj imponohet nevoja e ndërtimit të infrastrukturës dhe rregulloreve për mbështetjen e tyre efektive. Infrastruktura e sipërmarrësisë ka një rol kyç në zhvillimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ndërsa mungesa e infrastrukturës adekuate ka veprim frenues, jo vetëm ndaj zhvillimit të tyre, por edhe, përgjithësisht, ndaj rritjes ekonomike.

Zhvillimi i sipërmarrësisë dhe i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) është i rëndësishëm për të gjitha ekonomitë nacionale, e veçanërisht është i rëndësishëm për vendet në tranzicion, me qëllim të realizimit të rritjes dhe zhvillimit më intensiv ekonomik. Masat e zhvillimit më të shpejtë të këtij sektori në shtet, që merren në nivelin qendror dhe në atë vendor, bazohen në qasjen strategjike dhe të planifikuar me të vetmin qëllim – arritjen e pozitës konkurruese të ekonomisë sonë, e cila do të mundësojë pjesëmarrje të barabartë në tregun botëror, me çka do të përparhet dukshëm stili i jetesës dhe standardi i qytetarëve në qytetin e Shkupit dhe, me vetë këtë, edhe në Republikën e Maqedonisë.

Përgatitja e Propozim-strategjisë për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të sipërmarrësisë në Qytetin e Shkupit, me Plan të aksionit, për periudhën e viteve 2018-2021, i ka parasysh:

- Njohuritë teorike dhe praktike nga sfera e planifikimit strategjik, zhvillimit të sipërmarrësisë dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të zhvillimit ekonomik vendor;
- Arritjet e deritashme dhe përvoja praktike e palëve të interesuara (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) në shtet;
- Praktikën e mirë botërore në këtë sferë.

Si pikë nisëse e procesit të përgatitjes së Strategjisë është analiza e gjendjes ekzistuese, me qëllim që të caktohet shkalla e realizimit të Strategjisë së deritashme 2014-2017 dhe të caktohet nevoja reale e bashkësisë lokale.

Pasqyra e shkallës së realizimit të Strategjisë së NVM në vitet 2014-2017	
Në vazhdimësi	Pjesa më e madhe (90%) e projekteve dhe masave të cilat ishin pjesë përbërëse të Strategjisë për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme 2014-2017 kanë një rrjedhë vazhdimësie të realizimit të aktiviteteve
Të realizuara	5% tërësisht të realizuara, me tendencë që të rritet shkalla e projekteve të realizuara për shkak të vazhdimësisë së aktiviteteve
Të parealizuara	5% të parealizuara për shkak se ishte konstatuar që ingjerenat për realizimin e tyre janë në nivelin shtetëror dhe nevojitet një mbështetje më e madhe

1. Koncepti dhe metodologjia

Metodologjia i definon fazat dhe veprimet në procesin e përpunimit të Strategjisë për mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrësisë.


I përfshin kornizat kohore për realizimin e masave dhe aktiviteteve konkrete dhe e parashikon dinamikën e aktiviteteve përmes të cilave sigurohet realizimi i prioriteteve strategjike.

Strategjia për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrësisë të Qytetit të Shkupit, me Plan të aksionit për vitet 2018-2021 bazohet në këta aktivitete:

- **Analizë të gjendjes ekzistuese** me përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore në territorin e qytetit të Shkupit, me odat dhe institucionet tjera për mbështetjen e NVM, me përfaqësues të sektorit joqeveritar dhe të biznesit, **me qëllim të caktimit të shkallës së realizimit të strategjisë së deritashme, me një pasqyrim të mjeteve të planifikuara dhe të realizuara.**
- **Kornizë normative** – akte në bazë të të cilave është përgatitur Strategjia me qëllim të mbështetjes dhe zhvillimit të NVM dhe sipërmarrësisë.
 - Programi nacional i reformave ekonomike (vitet 2016-2018);
 - Politika industriale (vitet 2009-2020)
 - Plani Master për përmirësimin e konkurrencës (vitet 2015-2018)
 - Strategjia e inovacioneve (2012-2020)
 - Programi për nxitjen e investimeve në Republikën e Maqedonisë (vitet 2011-2014)
 - Strategjia për promovimin e eksportit (vitet 2011-2013)
 - Strategjia për mësim sipërmarrësie (2013-2020)
 - Agjenda e Lisbonës (viti 2000),
 - Akti i ndërmarrjeve të vogla i BE (ANV viti 2011)
 - Strategjia Evropa 2020,
 - Strategjia e Evropës juglindore 2020 (EJL 2020),
 - Plani i aksionit Sipërmarrje 2020 e BE
- **Mbledhja dhe analiza e propozimeve për zhvillimin e sektorit të NVM dhe sipërmarrësisë**– përmes përfshirjes së të gjitha palëve të interesuara relevante, me qëllim të përpunimit cilësor të strategjisë dhe planit të aksionit për çka është e domosdoshme që të sigurohet përkushtim i të gjithë partnerëve-pjesëmarrës në procesin. Bashkëpunimi me partnerët e përfshirë- pjesëmarrës, do të realizohet përmes organizimit të mbledhjeve të punës, takimeve dhe punëtorive me qëllim të fitimit të informatave të nevojshme dhe propozimeve për përcaktimin e nevojave zhvillimore dhe potencialeve zhvillimore të sektorit të NVM.
- **Ndjekja e statusit të realizimit të Strategjisë dhe Planit të aksionit**, përkatësisht realizimit të projekteve të planifikuara në raport me dinamikën e parashikuar. Rëndësi e veçantë e ndjekjes së progresit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara është marrja në kohë të duhur e informatës kthyesë të përgjegjësve për realizimin e planit të aksionit dhe nevojave për përshtatje eventuale dhe ndryshime në Strategjinë dhe Planin e aksionit.

Realizimi i Strategjisë dhe i Planit të aksionit do të bazohen në modelin e bashkëpunimit afatgjatë në të cilin koordinohen resurset e të gjithë partnerëve dhe resurset e Qytetit të Shkupit. Kjo duhet të rezultojë me përmirësim të vazhdueshëm të rezultateve në zhvillimin ekonomik të sektorit të NVM.

Në vazhdim është dhënë një pasqyrë skematike e metodologjisë dhe veprimit për përpunimin e Strategjisë dhe Planit të aksionit për NVM.



1.1 Analiza e gjendjes

- Analiza duhet të japë pamje të hollësishme të gjendjes së NVM dhe t'i vë themelet për një kuptim të thellë të gjendjes ekzistuese dhe të dinamikës së zhvillimit të NVM lidhur me demografinë, faktorët shoqërorë, resurset natyrore, infrastrukturën e disponueshme, cilësinë dhe mbrojtjen e ambientit jetësor.
- Analiza do të përmbajë të dhëna sasiore dhe cilësore dhe parametra nga bazat përkatëse të informatave (p.sh. Odat ekonomike, LOE, Enti shtetëror i statistikës, ministritë, njësitë e vetëqeverisjes vendore etj.).
- Nga cilësia e të dhënave hyrëse do të varet edhe cilësia e vlerësimit të gjendjes për zhvillimin e NVM, që është bazë për përcaktimin e vizionit, qëllimeve, përparësive dhe masave.
- Nga vetë analiza perceptohen dhe përcaktohen:
 - Karakteristikat pozitive dhe negative;
 - Problemet zhvillimore dhe nevojat e zhvillimit;
 - Indikatorët e zhvillimit të mëtejshëm të nevojshëm.

Analiza e të dhënave do të orientohet kah ata sektorë të cilët janë caktuar si problematikë ose potencialë për zhvillimin.

1.2 Definimi i prioriteteve, qëllimeve strategjike dhe masave

Vizioni

Vizioni është ide e përcaktuar qartësisht dhe saktësisht për ndryshimet e dëshiruara për mbështetje dhe zhvillim të NVM dhe sipërmarrësisë. Ai ka një formulim të përgjithshëm dhe nuk është konkretizuar në mënyrë specifike për ndonjë sektor të veçantë, por i referohet përparimit të përgjithshëm i cili duhet të arrihet.



Analiza SWOT është caktimi i nevojave dhe potencialeve zhvillimore

- **Qëllimi i analizës SWOT** është që të qartësohet gjendja konkrete përmes përcaktimit të anëve të fuqishme dhe të dobëta si dhe mundësive dhe kanosjeve për zhvillimin e mëtejshëm.
- **Dobësitë dhe kanosjet** analizohen në kontekst të nevojave zhvillimore ndërsa **përparësitë dhe mundësitë** në kontekst të potencialeve zhvillimore.
- **Përparësi** – janë sektorët, resurset dhe kapacitetet e NVM me mundësi më të mëdha për sukses.

- **Dobësi** – janë sektorët, resurset dhe kapacitetet të cilat e përkufizojnë ose pamundësojnë zhvillimin e NVM.
- **Mundësi** – janë sektorët, resurset dhe kapacitetet jashtë entitetit, të cilat do të mund të shfrytëzoheshin për zhvillimin e NVM (përparimi dhe përsosja e përparësive dhe/ose zvogëlimi i dobësive).
- **Kanosje** – janë sektorët, resurset dhe kapacitetet jashtë entitetit të cilat mund ta rrezikojnë zhvillimin e NVM (përmes zvogëlimit të përparësive dhe/ose theksimit dhe shtimit të dobësive).

Qëllimet strategjike

Si rezultat i analizës së gjendjes u theksuan pesë aspekte kyç (shtylla), nga të cilat dolën këta qëllime strategjike:

1. Mjedisi i favorshëm i biznesit (është përdorur analiza PESTLE)
2. Kulturë sipërmarrëse dhe mësim sipërmarrës
3. Inovacionet
4. Sektori produktiv dhe konkurrues i NVM
5. Financimi dhe gjendja financiare

Masat

Për çdo qëllim strategjik ishin përpunuar masa konkrete, aktivitete dhe projekte përmes realizimit të të cilave duhet të realizohen qëllimet strategjike.

Përcaktimi i prioriteteve të projekteve të propozuara

Pas definimit të propozimprojekteve për çdonjërin nga qëllimet strategjike, u përcaktuan prioritetet e masave dhe projekteve, në të cilat duhet të fokusohet Strategjia.

Përcaktimi i prioriteteve u zbatua përmes vlerësimit të masave/projekteve të definuara nga pjesëmarrësit e punëtorive të organizuara, përkthazi me tre aspekte në vijim:

1. Relevanca/arsyeshmëria e masës/projektit
2. Prioriteti i masës/projektit
3. Realizueshmëria (mundësitë) dhe parakushtet për realizimin e masës/projektit

Përmes vlerësimit përmblendës sa i përket tre aspekteve të para u fitua vlerësimi final për prioritetet e masave/projekteve konkrete.

Në këtë mënyrë u caktuan masat dhe projektet parësore në të cilat duhet të fokusohet strategjia, e të cilat kanë të bëjnë, para së gjithash, me:

- Zhvillimin e sipërmarrësisë sociale/promovim i kulturës së sipërmarrësisë
- Trajnime sa u përket programeve relevante për stimulimin e hapjes dhe zhvillimit të NVM.
- Hapjen e inkubatorëve të biznesit për mbështetjen e NVM të reja.
- Fushatat informative dhe edukative për arsimim financiar, arsimim digjital etj.

1.3 Ndjekja e statusit të zbatimit të Strategjisë dhe planit të aksionit

Ndjekja e statusit të zbatimit të strategjisë dhe planit të aksionit do të realizohen përmes roleve dhe përgjegjësi, qartësisht të përcaktuara dhe të definuara, të bartësve dhe shfrytëzuesve të masave dhe aktiviteteve konkrete si dhe obligimit të tyre për dhënien në kohë të informatës kthyesë atyre që janë përgjegjës për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të definuara, si dhe nevojave për përshtatje dhe ndryshime eventuale të Strategjisë dhe Planit të aksionit.

1.4 Pjesëmarrësit në proces

Bartës i procesit të përgatitjes dhe realizimit të Strategjisë dhe Planit të aksionit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për periudhën e viteve 2018-2021, është qyteti i Shkupit, përkatësisht Sektori për zhvillim ekonomik vendor të Qytetit të Shkupit, me përkrahjen e kompanisë Evrosimovski Konsalting.

Pjesëmarrësit e përfshirë aktivisht gjatë përpunimit të Strategjisë dhe Planit të aksionit ishin përfaqësues të caktuar nga këta institucione:

- Qyteti i Shkupit (sektorët relevantë)
- Komunat në qytetin e Shkupit
- Shoqata, asociacione të NVM dhe oda ekonomike
- Organizata joqeveritare
- Ministri dhe institucione të tjera publike

Lista e pjesëmarrësve është dhënë në shtojcën 1.

2. Pasqyra e aktiviteteve të realizuara më të rëndësishme

Për përpunimin e Strategjisë për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe për sipërmarrësi të Qytetit të Shkupit, me plan të aksionit, për periudhën e viteve 2018-2021, në periudhën prej shkurtit deri në korrik të vitit 2018 janë realizuar këta aktivitete:

1. Nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet qytetit të Shkupit dhe zbatuesit të projektit – EVROSIMOVSKI Konsalting dhe fillimi i përgatitjes së Strategjisë
2. Definimi dhe harmonizimi i metodologjisë dhe konceptit me propozime të aktiviteteve dhe kornizës kohore për realizimin e projektit.
Metodologjia i definonte fazat dhe veprimet në procesin e përpunimit të Strategjisë për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe për sipërmarrëse i të qytetit të Shkupit, me plan të aksionit, për periudhën e viteve 2018-2021. U definuan kornizat kohore për realizimin e masave dhe aktiviteteve konkrete përmes të cilave sigurohet realizimi i prioriteteve strategjike.
3. Realizimi i prezantimit hyrës dhe punëtorisë për analizën SWOT në qytetin e Shkupit.
4. Analiza e dokumenteve ekzistuese strategjike dhe e ligjeve relevante për zhvillimin e sipërmarrësisë dhe mbështetjen e NVM në nivel vendos, rajonal dhe nacional.
Revizioni i strategjisë ekzistuese me analizë të shkallës së realizimit të strategjisë, pasqyra e mjeteve të planifikuara dhe të realizuara dhe dhënia e komenteve dhe konkluzioneve.
5. Përgatitja dhe dorëzimi i Pyetësit për analizën e mendimeve dhe përgatitjen e Strategjisë për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe për sipërmarrësi të Qytetit të Shkupit, me plan të aksionit, për periudhën e viteve 2018-2021

Përgjigjet e pyetësit anketues dhe propozimet e dhëna përmes pyetësit të plotësuar janë pjesë përbërëse e projekteve të propozuara në Strategjinë për periudhën e ardhshme katërvjeçare të viteve 2018-2021.

Qenë të përfshira pyetje lidhur me:

- Gjejden ekzistuese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e qytetit të Shkupit (me cilat sfida dhe probleme përballen NVM, nevojat e NVM)

- propozime për përmirësimin ambientit afarist në NVM dhe për qasjen e mundshme deri te burimet e financimit të punës së tyre
- ide dhe propozime për nxitjen mësimi sipërmarrës dhe kulturës sipërmarrëse
- ide dhe propozime për nxitjen e sipërmarrësisë sociale (integrimi i qëllimeve ekonomike dhe sociale, zgjidhja e sfidave sociale dhe ekonomike dhe forcimin e rritjes inkluzive
- projekte të planifikuara që janë të rëndësishme për NVM
- Nevoja zhvillimore (nevoja të NVM për zhvillim dhe përparim të mëtejshëm të punës së tyre)
- Potenciale zhvillimore (potenciale dhe mundësi që ekzistojnë dhe të cilat duhet të theksohen dhe të realizohen)

Pyetësi u qe dorëzuar:

- Anëtarëve të grupit të punës nga Qyteti i Shkupit
- 8 sektorëve në Qytetin e Shkupit
- Të gjitha komunave të Qytetit të Shkupit (10)
- Lidhjes së Odave Ekonomike dhe Odës Ekonomike, e përmes tyre, anëtarëve të odave dhe përfaqësuesve të sektorit të biznesit, në përputhje me përzgjedhjen përkatës nga ana e odave
- Odës së zejtarëve
- Ministrisë së ekonomisë
- Ministrive dhe institucioneve
- Sektorit joqeveritar (minimum 10 OJQ)

Procedura për dorëzimin e pyetësorit u përsërit edhe gjatë muajit qershor me qëllim që të merret një numër optimal i pyetësorëve tërësisht të plotësuar.

6. Analizë e gjendjes ekzistuese nga sfera e sipërmarrësisë dhe e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Qytetin e Shkupit.
7. Mbajtje e punëtorisë dyditore më 13-14 qershor në Strumicë për përpunimin e Strategjisë për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe për sipërmarrësi të Qytetit të Shkupit.
U organizua (moderua) seminar për definimin e vizionit, misionit dhe qëllimeve strategjike si dhe për definimin dhe hartimin e projekteve, në përputhje me qëllimet dhe prioritetet strategjike.
8. Analizë e përgjigjeve, mendimeve, propozimeve dhe ideve për projektet, të marra nga të gjithë palët e përfshirë
9. Projekti i Strategjisë – draft

10. Pritja e vërejtjeve

11. Inkorporimi i vërejtjeve dhe versioni përfundimtar i Strategjisë

3. Gjendja ekzistuese në sektorin e sipërmarrësisë dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë dhe në Qytetin e Shkupit

Strategjia është përgatitur me qëllim të mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) që të bëhen më konkurse në tregun e vendit dhe atë të jashtëm, duke iu përshtatur ekonomisë botërore, gjithnjë e më të integruar.

Për të pasur një pasqyrë më reale të gjendjes ekzistuese në sektorin e sipërmarrësisë dhe NVM në Qytetin e Shkupit, u analizuan të dhënat nga dokumentet dhe strategjitë relevante që kanë të bëjnë me Republikën e Maqedonisë, të plotësuara me të dhëna dhe njohuri të caktuara statistikore të marra nga hulumtimet e bëra veçanërisht për nevojat e përgatitjes së kësaj Strategjie, ndërsa kanë të bëjnë me gjendjen me NVM dhe sipërmarrësinë në qytetin e Shkupit. Shfaqja e gjendjes ekzistuese bazohet në të dhëna statistikore, analizën e mendimeve dhe të dhënave të marra gjatë komunikimit me palët e interesuara si dhe me përfaqësuesit, anëtarë të grupit të punës për përgatitjen e kësaj Strategjie; rezultatet nga punëtoritë e mbajtura me përfaqësues nga të gjitha komunat në Qytetin e Shkupit, nga sektori publik dhe privat dhe nga odat ekonomike.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kanë rol relevant në ekonominë e shumë vendeve. Ata paraqesin burim të madh të aftësive sipërmarrëse, inovacioneve dhe punësimit.

Krijimi dhe zhvillimi i NVM është i rëndësishëm për atë se ata paraqesin gjeneratorin kryesor të vendeve të reja të punës, e angazhojnë kapitalin e lirë të qytetarëve, i aktivizojnë dhe punësojnë të gjitha resurset vendore që i kanë, janë fleksibil në raport me ndryshimet dinamike në treg, janë burim inovacionesh etj. Rëndësia ekonomike e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është e madhe dhe thelbësore në zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik të një vendi, ngase paraqesin një prej forcave lëvizëse kryesore për arritjen e një rritjeje të shpejtuar ekonomike.

3.1 Strategji dhe dokumente shtetërore të cilat e definojnë funksionimin e sipërmarrësisë dhe NVM në Maqedoni

Strategjia nacionale për NVM e vendos kornizën e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të sektorit publik dhe atij privat dhe shoqërisë civile në mbështetjen e zhvillimit të NVM dhe novatorizmit për përmirësimin e aftësisë së tyre konkurruese

Programi nacional për reforma ekonomike (për vitet 2016-2018) i përshkruan reformat e kornizës afatmesme makroekonomike dhe fiskale si dhe reformat strukturore të sektorëve që janë të nevojshme për përmirësimin e aftësisë konkurruese dhe zhvillimit.

Politika industriale (për vitet 2009-2020) e përcakton vizionin për sektor industrial që është i orientuar kah “prodhimet dhe shërbimet me vlerë të shtuar më të lartë, të bazuar në diturinë, inovacionet dhe bashkëpunimin e ndërsjellë”. Ky vizion bazohet në zhvillimin e aftësive për “hulumtime të aplikueshme dhe prodhimtari të prodhimeve të qëndrueshme, organike dhe të specializuara me teknologji të lartë dhe shërbime që do t'i kënaqin nevojat e tregjeve të segmentuara ndërkombëtare.

Strategjia nacionale për inovacione (2012-2020) synon fillimin e transformimit të vendit në një ekonomi të bazuar në dituri, që është e aftë të jetë konkurruese në tregjet ndërkombëtare përmes forcës së saj të trajnuar dhe shoqërive inovative. Ajo i shquan inovacionet si forcë kyçe lëvizëse të rritjes ekonomike dhe ka për qëllim t'i nxisë konkurrencën dhe zhvillimin ekonomik në bazë të diturive dhe inovacioneve.

Programi për nxitjen e investimeve në Republikën e Maqedonisë (për vitet 2011-2014) synon zhvillimin e politikave dhe zbatimin e reformave që do të sjellin rritje dhe zhvillim më dinamik ekonomik, duke e rritur atraktivitetin e vendit për investues të vendit dhe të jashtëm. Programi ka synim përmirësimin e klimës së përgjithshme afariste dhe investuese përmes politikave më të qëndrueshme makroekonomike dhe fiskale, politikave të përmirësuara tatimore dhe doganore dhe përkrahjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Strategjia për promovimin e eksportit (për vitet 2011-2013) e shënon rrugën deri në rritjen e vlerës së eksportit të gjeneruar nga kompanitë e Maqedonisë prej 1.12 miliardë USD në 1.45 miliardë USD. Ajo fokusohet në katër sektorë të industrisë: tekstil dhe veshje, agrobiznes dhe industri ushqimore, industri të metaleve dhe mekanikë precize dhe TIK.

Strategjia e mësimi sipërmarrës (2013-2020) ka për qëllim ta përmirësojë aftësinë konkurruese të NVM-ve çanërisht të atyre të udhëhiqen nga persona të rinj dhe femra për konkurrim të suksesshëm në tregjet e BE. Strategjia do ta arrijë këtë përmes

përmirësimit të shkathtësive për punësim dhe kompetenca sipërmarrëse të personave të rinj dhe forcim të frymës sipërmarrëse përmes parimeve për mësim gjatë gjithë jetës që janë inkorporuar në të gjitha segmentet e sistemit të arsimit.

Republika e Maqedonisë mori statusin e vendit-kandidat për anëtarësim në BE, që ka implikime të mëdha ndaj strategjisë dhe programit për NVM, sa i përket shpejtimin të harmonizimit të legjislacionit nacional dhe legjislacionit të BE dhe nevojës për zbatimin e Kartës së rishikuar evropiane për ndërmarrje të vogla. Iniciativat e reja, siç janë Instrumenti për ndihmë paraaderuese dhe Programi kornizë i BE për konkurrencë dhe inovacione (periudha vijuese 2014-2020) paraqesin sfida të reja dhe mundësi sa i përket shkencës, teknologjisë dhe inovacioneve si dhe teknologjisë informatike- komunikuese(TIK) si mjete të rritjes së konkurrencës të NVM.

Akti për ndërmarrje të vogla i BE (ANV viti 2011) paraqet kornizë gjithëpërfshirëse për politikën e BE për NVM. Ai ka për qëllim ta përmirësojë qasjen ndaj sipërmarrësisë në Evropë, ta thjeshtësojë ambientin e rregulloreve dhe politikave për NVM dhe t'i evitojë pengesat tjera për zhvillimin e tyre. ANV që lidhet me Kartën evropiane të ndërmarrjeve të vogla (v. 2000) i përcakton këta prioritete: përparimin e sipërmarrësisë, zvogëlimin e ngarkesës rregulluese, përmirësimin e qasjes deri te financat dhe përmirësimin e qasjes së NVM deri te tregjet dhe internacionalizimi.

3.2 Profili i NVM dhe sfidat

Strategjia e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe e sipërmarrësisë, në vitet 2018-2021, ka për qëllim t'u përgjigjet sfidave kritike dhe çështjeve me të cilat përballlet sektori i NVM në qytetin e Shkupit, si dhe ta rrisë vetëdijen për nevojën e kultivimit të kulturës sipërmarrëse me qëllimin përfundimtar –mundësi më të mëdha për punësim, rritje të cilësisë së jetesës, stabilitet financiar, zvogëlim të varfërisë dhe zhvillim më të madh ekonomik.

3.2.1 Përkufizimi për NVM

Republika e Maqedonisë përdor përkufizim unik kurse NVM, Neni 470 për klasifikimin e subjekteve tregtare në Ligjin për kompanitë tregtare nga viti 2004, e përcakton përkufizimin në ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme. Ky përkufizim është harmonizuar me përkufizimin e BE (Rekomandimi i BE 2003/361) përkitazi me pragjet për numrin e të punësuarve, por përcakton edhe kritere shtesë për klasifikimin e ndërmarrjeve.

Tabela 3.2.1: Përkufizimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme

Madhësia e shoqatës	Përkufizimi i BE	Ligji për kompanitë tregtare v.2004 (i ndryshuar dhe i plotësuar në vitin 2013)
Mikro	<10 të punësuar ≤2 milionë EUR qarkullim ose bilanc të gjendjes	<10 të punësuar ≤ 50.000 EUR bruto të ardhura vjetore, të shprehura në MKD
E vogël	10 deri në 50 të punësuar 2–10 milionë EUR qarkullim ose bilanc të gjendjes	≤ 50 të punësuar, dhe 2 milionë EUR të ardhura vjetore, të shprehura në MKD, OSE < 2 milionë EUR qarkullim vjetor (mjete të përgjithshme në aktivë), të shprehura në MKD
E mesme	<250 të punësuar ≤ 50 milionë EUR qarkullim ≤ 43 milionë EUR bilanc të gjendjes	≤250 të punësuar, dhe ≥10 milionë EUR të ardhura vjetore, të shprehura në MKD, OSE < 11 milionë EUR qarkullim vjetor (mjete të përgjithshme në aktivë), të shprehura në MKD

Ky definim siguron kornizë të përgjithshme për përcaktimin, ndjekjen dhe mbështetjen e sektorit privat nga të gjitha institucionet e të gjitha niveleve. Definimi mbetet konsistent për të gjithë sektorët industrialë.

Pavarësisht madhësisë së kompanive individuale, sektori i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) si tërësi, është dominant në ekonominë e Maqedonisë. Të dhënat më të reja tregojnë se 99.8 për qind e të gjitha ndërmarrjeve janë në sektorin e NVM.

NVM janë punëdhënësit më të mëdhenj, duke siguruar 80% të të gjitha punësimeve. Nga ky aspekt, është verifikuar se ndërmarrjet mikro punësojnë një të tretën e numrit të përgjithshëm të punëtorëve, ndërsa NVM bashkërisht punësojnë 43% të të gjithë punëtorëve. Të paktat ndërmarrje të mëdha që gjenden në vend, secila prej tyre me më shumë se 250 të punësuar, sigurojnë punësim për 23% të forcës punëtore.

3.3 Sfidat kyçe me të cilat përballen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

○ Ambienti afarist

Republika e Maqedonisë ka një ambient relativisht të mirë afarist, por ai mundet dhe, gjithsesi, duhet të përmirësohet. Sipas Raportit për konkurrencë globale, për vitet 2016-2017, të publikuar nga Forumi ekonomik botëror, në të cilin është identifikuar indeksi i konkurrencës së 140 shteteve, i llogaritur në bazë të 12 faktorëve siç janë: niveli i produktivitetit të vendit, duke përfshirë institucionet, infrastrukturën, mjedisin makroekonomik, shëndetësinë, arsimin, zhvillimin e tregut të financave, gatishmërinë teknologjike, madhësinë e tregut, inovacionin, duke përfshirë edhe shkallën e përgjithshme tatimore, e cila e paraqet shumën e tatimeve dhe kontributeve të cilat patjetër duhet të paguhen nga biznesi. R. e Maqedonisë, me riorganizimin e sistemit të vet tatimor në vitin 2008, arriti të vendosë një shkallë tatimore totale prej 7.4%, me

të cilën radhitet ndër vendet me shkallë më të ulëta tatimore në botë. Banka botërore në raportin e vet të fundit “Doing biznis” për vitin 2017 e radhiti Maqedoninë në 10 më të mirët në botë dhe në 5 të parët në Evropë, sipas kushteve për zhvillimin e biznesit.

Kushte për zhvillim të mëtejshëm të biznesit

Ekzistojnë shumë organizata, programe dhe projekte për mbështetjen e NVM. Ndërkaq, ata më shpesh sigurohen drejtpërdrejt nga qeveria dhe nga partnerët dhe donatorët ndërkombëtarë. Gjithashtu, ekziston një numër i madh dhënësish të shërbimeve nga sektori privat, në territorin e qytetit të Shkupit. Në disa vitet e fundit, modelet tradicionale për mbështetjen e ndërmarrjeve në themelim (ndërmarrje „start-ap“) dhe zhvillimit (përkatesisht trajnime për shkathtësi afariste, konkurse për plane afariste) zëvendësohen me modele të reja. Trajnimi i ndërmarrjeve fokusohet në “akselerimin e biznesit” që parashikon trajnim intensiv prej tre deri në katër muaj me gatishmëri për investim.

○ Shërbime financiare

Një numër i madh i NVM kanë probleme me qasjen të shërbimeve financiare. Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë thekson se qasje deri te financat mbetet e vështirë për NVM, duke pasur parasysh pengesat, si në ofertën, ashtu edhe në kërkesat e kredive, pa marrë parasysh likuiditetin e bollshëm të bankave. Ky problem është vënë re gjithkund në vend. Financimi me marrje të borxhit është në nivel të ulët në krahasim me vendet e tjera. Ngjashëm me këtë, shfrytëzimi i engjëjve të biznesit dhe kapitalit sipërmarrës është në nivel të ulët.

○ Produktiviteti dhe Kushtet e punës

Arsimi dhe trajnimi i kontribuojnë zhvillimit të ekonomisë që bazohet në diturinë dhe, përgjithësisht, në zhvillimin ekonomik. Nga pikëpamja e NVM, arsimi dhe trajnimi dhe disponueshmëria e shkathtësive të kërkuara janë faktorë esencjalë zhvillimorë. Në mënyrë plotësuese, qasje deri te fuqia e kualifikuar punëtore është njëra prej fushave më problematike, kur bëhet fjalë për NVM.

3.4 Demografia e biznesit dhe dinamika e biznesit

Numri i madh i bizneseve dhe konkurrenca e shëndoshë janë pjesë e bazës për ekonomi të suksesshme të një vendi. Me reformat ekonomike dhe disa nga politikat, siç janë fushatat për tërheqjen e investimeve të huaja dhe subvencionimi i vetëpunësimit, krijohen kushte për zhvillimin e bizneseve tanimë ekzistuese si dhe

për mbështetjen e ideve për biznese të reja, duke krijuar mundësi për njerëzit e të gjitha shtresave, moshave dhe vendit të jetesës. Duke i zvogëluar dallimet sociale dhe fenomenet negative sociale dhe duke krijuar kushte të volitshme për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore qëllimi ishte që të mundësohet biznes i papenguar dhe zhvillim demografik në tërë vendin.

3.5 Ndërmarrje aktive nëpër komuna

Të dhënat vjetore për demografinë e biznesit përfshijnë variabla të cilat i shpjegojnë karakteristikat dhe demografinë e një zone të caktuar biznesi për një vit të caktuar. Ndërmarrjet aktive të ndara nëpër komuna gjithashtu paraqesin indikator të rëndësishëm që vë në dukje dendësinë e ndërmarrjeve në rajone të caktuara. Në të vërtetë, ashtu siç rritet numri i ndërmarrjeve në një rajon të caktuar, i njëjti rajon bëhet më i zhvilluar dhe rritet konkurrenca ndërmjet ndërmarrjeve.

Numri i ndërmarrjeve të regjistruara në Maqedoni rritet prej viti në vit. Numri më i madh i atyre ndërmarrjeve bëjnë pjesë në kategorinë ndërmarrje të vogla.

Subjekte aktive afariste sipas madhësisë, nëpër komuna në Qytetin e Shkupit

	Gjithsej	Mikro	Të vogla	Të mesme	Të mëdha
Republika e Maqedonisë	71419	48577	21543	776	523
Shkupi	25539	15575	9250	365	349
Aerodromi	3565	2295	1219	25	26
Buteli	1413	871	494	29	19
Gazi Baba	2720	1610	1015	48	47
Gjorçe Petrovi	1522	1025	475	12	10
Karposhi	3929	2284	1538	49	58
Kisella Voda	2762	1768	941	36	17
Sarai	470	302	159	7	2
Qendra	7069	3836	2917	147	169
Çairi	1863	1416	437	10	-

Shuto Orizari	226	168	55	2	1
---------------	-----	-----	----	---	---

4. Përparësia konkurruese e Qytetit të Shkupit për zhvillimin e NVM dhe sipërmarrësi në raport me komunat e tjera

Përparësitë krahasuese të Qytetit të Shkupit janë identifikuar përmes analizës SWOT, të bërë në bazë të hulumtimit të anëve të dobëta dhe të forta të ambientit të biznesit, që i përmban përmbledhja e dokumenteve të tjera strategjike të Qytetit, përpunimi i të njëjtëve si dhe analiza e gjendjes ekzistuese e bërë në punëtoritë e mbajtura.

Përparësitë konkurruese të Qytetit të Shkupit janë treguar si anë të forta dhe i potencojnë faktorët që e bëjnë Qytetin e Shkupit vend të volitshëm për punë dhe rritje dhe për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, për punë dhe jetesë. Anët e dobëta, të paraqitura si fakte dhe trend, paraqesin pengesa dhe/ose kufizim të zhvillimit. Mundësitë janë kushte të cilat do ta mundësonin dhe lehtësonin zhvillimin e përparësive konkurruese, ndërsa kanosjet janë trend të pavolitshme që sjellin rënien e përparësisë konkurruese të zhvillimit dhe rritjes së NVM.

Për identifikimin e përparësisë konkurruese të Qytetit të Shkupit nga aspekti i zhvillimit të NVM dhe sipërmarrësisë, në raport me komunat e tjera, u bë analizë e mendimeve të përfaqësuesve nga Qyteti i Shkupit, gjatë mbajtjes së punëtorisë për pasqyrën e analizës SWOT. Krahas analizës së gjendjes ekzistuese me sipërmarrësinë dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë dhe në Qytetin e Shkupit, të bërë kryesisht me ndihmën e të dhënave statistikore nga hulumtimet primare dhe sekondare për klimën ekonomike dhe afariste në qytetin dhe në shtetin,

Elementet prej nga duhet nxjerrë përparësinë konkurruese të qytetit të Shkupit në procesin e mbështetjes dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrësisë, janë ndarë në dy pjesë:

- Anë të forta dhe të dobëta të brendshme** të aktorëve dhe pjesëmarrësve në sektorin e NVM dhe sipërmarrësisë të Qytetit të Shkupit

Anë të forta	Anë të dobëta
1. Fuqi punëtore e arsimuar mirë në tregun e punës të qytetit të Shkupit	1. Mungesë informacionesh për sipërmarrësit

2. Qendër arsimore (numër i madh universitetesh, fakultetesh, shkollash të mesme profesionale) 3. Numër i madh i firmave dhe kërkesave në tregun e fuqisë punëtore 4. Ofertë e madhe dhe cilësore në tregun e fuqisë punëtore me mundësi për zgjedhje të madhe 5. Pozitë e mirë gjeografike e qytetit të Shkupit, në mes të shtetit 6. Ekzistimi i infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, të aeroportit, komunale) 7. Potencial i madh ekonomik 8. Qasje e lehtë dhe e shpejte të gjitha institucionet 9. Shpenzime më të vogla administrative dhe të transportit 10. Ekzistimi i qendrave të panairëve, kongreseve, turistike dhe ekspozuese 11. Numër i madh kompanish konsultuese 12. Numër i madh dhe llojshmëri kompanish ku studentët/nxënësit mund të vizitojnë mësim praktik ose punë praktike 13. Rritje e bashkëpunimit ndërmjet kompanive dhe shkollave/universiteteve (aplikimi i metodave shkencore në kompani dhe ndërmarrje sipërmarrësish, mundësi për mësim praktik dhe punë të nxënësve/studentëve në kompanitë, projekte të përbashkëta) 14. Bashkëpunim i mirë i qytetit të Shkupit me komunat e Shkupit sa i përket zhvillimit të ekonomisë vendore 15. Treg i madh	2. Mosnjohje e nevojave dhe kërkesave të konsumatorëve 3. Konkurrencë e madhe 4. Shpenzime më të larta për furnizime, qira dhe mirëmbajtje të mirave materiale të nevojshme për zhvillimin e biznesit 5. Çmim më i lartë i fuqisë punëtore në raport me komunat tjera në shtet 6. Nuk ekziston praktikë e rregullt e bashkëpunimit të qytetit të Shkupit dhe komunave në qytet me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme 7. Mungesë informimi të mirë në administratën vendore për programet lidhur me NVM dhe sipërmarrësin, të parashikuara në nivel qendror 8. Mundësi e zvogëluar për prezantim komercial të NVM 9. Jolikuiditet i NVM 10. Mosnjohje e mirë e rregulloreve dhe ligjeve nga ana e sipërmarrësve dhe NVM 11. Mungesë e mjeteve financiare të vetëqeverisja vendore dhe NVM për bashkëfinancimin e projekteve 12. Mungesë e infrastrukturës institucionale në nivel lokal për ndihmë NVM-ve 13. Mosharmonizim i programeve mësimore në arsimin sipëror sipas nevojave të tregut të punës 14. Të punësuarit më të moshuar nuk kanë dëshirë për riedukim dhe mësim tërëjetësor 15. Nivel i ulët i njohjes së procedurave, aplikimit dhe shfrytëzimit të fondeve të BE për mbështetje të NVM-ve dhe sipërmarrësisë
--	--

16. Ekzistimi i programeve për vetëpunësim	16. Jolidhshmëri dhe moskoordinim të institucioneve për mbështetje të NVM-ve dhe sipërmarrësisë 17. Mungesë kapaciteti të administratës publike për përgatitjen e dokumentacionit për projekte 18. NVM kryesisht kanë mungesë të resurseve dhe diturive 19. Dituri afariste, shkathtësi dhe novatorizëm të pamjaftueshme të sipërmarrësve 20. Mosnjohje e teknikave të marketingut dhe nivel i ulët i aktiviteteve të marketingut në NVM 21. Kyçje e dobët e NVM në sistemin e odave për shfrytëzimin e informatave dhe për lidhjen me firma të tjera të vendit të të 22. Mundësi e dobët financiare për sigurimin e kolateralit për kredi të NVM 23. Joefikasitet i administratës vendore 24. Cilësi, ambalazh dhe çmim jo adekuatë të prodhimeve dhe shërbimeve për depërtimin e tyre në tregun ndërkombëtar 25. Kujdes jo adekuat për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe për politikat e përgjegjësisë shoqërore 26. Bashkëpunim i pamjaftueshëm i NVM me kompanitë që punojnë në zonat zhvillimore teknologjike industriale
---	---

Mundësi dhe kanosje që vijnë jasht faktorëve dhe pjesëmarrësve në sektorin e NVM dhe sipërmarrësisë në qytetin e Shkupit

Mundësi	Kanosje
---------	---------

1. BNJVL mundëson promovimin e qytetit të Shkupit dhe komunave të qytetit dhe implementon programe për mbështetjen e tyre në aktivitetet e lidhura me ZHEL 2. Përkushtim i fuqishëm dhe mbështetje e institucioneve të BE për NVM dhe sipërmarrësi 3. Përfshirje proaktive dhe aplikim me projekte të BE, programe të përkrahjes së NVM dhe sipërmarrësisë 4. Rrjetëzimi ndërmjet më shumë faktorëve shoqëror në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar 5. Ekzistimi i institucioneve dhe programeve për mësim gjatë gjithë jetës, për rikualifikim dhe ritrajnim 6. Agjencia e investimeve të huaja dhe promovimi i eksportit të Republikës së Maqedonisë (dhe promotorët ekonomikë jashtë vendit) mundëson promovimin e qytetit të Shkupit, komunave dhe potencialeve të tyre për investim dhe biznes 7. Hyrja e një numri të madh investimesh të huaja 8. Afërsia e disa zonave zhvillimore teknologjike industriale 9. Subvencionimi i trajnimeve për të papunësuarit 10. Nxitje e shoqërimit klasterik 11. Qyteti i Shkupit si pjesë e strategjisë së RM për tërheqjen e investimeve të huaja. 12. Përfshirja e qytetit të Shkupit në krijimin dhe realizimin e strategjisë nacionale për mbështetjen e NVM dhe sipërmarrësisë në RM. 13. Përfshirja aktive në rrjetat rajonale të institucioneve për	1. Komunikimi në relacionin komuna në qytetin e Shkupit-BNJVL-Qeveria e RM- Kuvendi i RM 2. Konkurenca nga korporacionet e jashtme dhe përfaqësive të tyre 3. Inkorporimi i legjislacionit të ri evropian në legjislacionin nacional 4. Shpenzime më të mëdha për jetesë dhe zhvillim të biznesit 5. Plaket popullata në qytetin e Shkupit dhe ne komunat e Shkupit 6. Mungesa e regjistrat të investuesve potencialë të interesuar 7. Bashkëpunim i pamjaftueshëm ndërmjet institucioneve nga sfera e mbështetjes dhe zhvillimit të NVM dhe sipërmarrësisë në nivelin lokal dhe atë qendror 8. Mospërparimi i infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore që shkon nga/deri në qytetin e Shkupit 9. Mospërfshirja e qyteti të Shkupit në iniciativa dhe bashkëpunim rajonale për zhvillimin e NVM dhe sipërmarrësisë 10. Pjesëmarrje e dobët e NVM në procedurat e furnizimeve publike 11. Derdhja e fuqisë punëtore jashtë vendit 12. Burrime të favorshme për financimin e NVM jo mjaft të disponueshme
--	---

mbështetjen e NVM, me qëllim të lidhjes dhe bashkëpunimit rajonal të firmave	
14. Promovimi i Republikës së Maqedonisë si destinacion i mirë biznesi	
15. Infrastruktura e mirë për qasje në internet	
16. Përparimi i bashkëpunimit të institucioneve vendore me sektorin e biznesit	
17. Rritja e mbështetjes dhe projekteve për zhvillimin e NVM dhe sipërmarrësisë në nivel lokal	
18. Shfrytëzim më i madh i kredive prej BMMZH nga ana e NVM të qytetit të Shkupit	
19. Zhvillimi i bizneseve “të gjelbra” përfshirë edhe ata nga sfera e menaxhimit në lloje të ndryshme hedhurinash	
20. Forcimi dhe zbatimi i konceptit partneritet publik- privat	

5. Parime të politikës mbështetëse

Politikat në shenjë mbështetjeje të rritjes së lartë të NVM përfshijnë dy çështje:

- Politikat e nxitjes së një numri të madh të NVM, si dhe
- Politikat e mbështetjes së NVM, me qëllim që të mbahet rritja e tyre e lartë.

Politikat e nxitjes së numrit të shtuar të NVM sigurojnë ambient të volitshëm afarist për rritjen dhe zhvillimin e ardhëm të lartë të kulturës sipërmarrëse, ndërsa politikat e mbështetjes së rritjes së lartë të NVM kanë për qëllim të sigurojnë sektor konkurrues dhe produktiv të NVM.

Në praktikë, politikat e nxitjes së rritjes së NVM kanë tendencë që të fokusohen në aktivitetet për hulumtimin e zhvillimit dhe të qasjes te financat.

Pikërisht për këtë, Qyteti i Shkupit vendos politika adekuate për rritje të lartë të ndërmarrjeve në bazë të këtyre parimeve:

- **Selektivitet.** Iniciativat të cilat kërkojnë të promovohet rritje e shpejtë duhet të kenë një selektivitet të lartë gjatë përzgjedhjes së ndërmarrjeve dhe sipërmarrësve që do të marrin pjesë ngase vetëm një pjesë e tyre e vogël ka aftësi dhe gatishmëri që ta arrijë këtë.
- **Proaktivitet.** Agjencitë duhet aktivisht të vështrojnë ambientin për rritjen e firmave me potencial të lartë, me qëllim që të zhvillojnë politika adekuate për mbështetjen e tyre. Megjithatë, qasja proaktive und të nxisë aplikimin e praktikave të papranueshme të keqpërdorimit, ashtu që firma të caktuara do të trajtoheshin si të diskriminuara. Prandaj, qasja proaktive duhet të aplikohet me vëmendje.
- **Bashkëpunimi me sektorin privat.** Pjesëmarrje aktive e aktorëve nga sektori privat, të cilët sigurojnë përvojë të bazuar në shkathtësi në menaxhim me rritjen dhe e përmirësojnë kredibilitetin e iniciativave. Ngandonjëherë firmat me potencial të lartë kanë tendencë t'i shmangen mbështetjes publike si joefikase dhe jo mjaft të sofistikuar.
- **Profesionalizmi.** Agjencitë, fondet dhe institucionet e tjera të përkrahjes duhet të bazohen në parimet e profesionalizmit, kompetencës dhe një shkallë të caktuar të ekskluzivitetit, me qëllim që të mund të sigurohet vlerë e njëmendët.
- **Përpjekje të qëndrueshme.** Rritja firmës mund të jetë jo e vazhdueshme. Situata e këtillë imponon angazhime të vazhdueshme dhe "gatishmëri për t'u përballur me humbjet".
- **Fokusimi i shkathtësive.** Nëse menaxhimi i rritjes është detyrë e veçantë, politika duhet të synojë drejt zhvillimit të kompetencave të menaxhimit.

6. Vizioni, misioni dhe qëllimet strategjike

“NVM kompetente, inovative dhe konkurruese, përmes standardizimit dhe certifikimit me mundësimin e qasjes në tregjet e reja ndërkombëtare përmes harmonizimit me standardet e BE”.

6.1 Vizioni i Strategjisë:

Qyteti i Shkupit – qendër evropiane biznesi, qytet me përgjegjësi sociale me ekonomi të qëndrueshme, të bazuar në dituri, inovacione dhe me fuqi punëtore me kualifikim të lartë dhe kreativ. Bashkësi e qëndrueshme e biznesit, qytet promotor i bizneseve sociale me sipërmarrësi të zhvilluar sociale, në të cilën përdoren praktikat më të mira botërore dhe krijohen kushte për jetesë cilësore, sukses afatgjatë dhe për përparim të vazhdueshëm të bashkësisë. NVM produktive, inovative dhe konkurruese përmes standardizimit dhe certifikimit

duke mundësuar qasje në tregjet e reja ndërkombëtare përmes harmonizimit me standardet e BE.

6.2 Misioni i Strategjisë

Kjo Strategji ka për qëllim të krijojë parakushte që NVM në territorin e Qytetit të Shkupit të bëhen iniciatorë dhe promotorë të rritjes së gjithëmbarshme ekonomike.

6.3 Qëllimet strategjike:

1. Ambient i volitshëm afarist
2. Mësim sipërmarrësie dhe kulturë sipërmarrësie
3. Inovacione
4. Sektor produktiv dhe konkurrues i NVM (NVM produktive dhe inovative në tregun e brendshëm dhe njëherësh pjesëmarrës konkurrues në tregjet e huaja)
5. Financimi (mundësi dhe mënyra)

“NVM produktivë, inovativë dhe konkurrues, përmes standardizimit dhe certifikimit me mundësimin e qasjes në tregjet e reja ndërkombëtare përmes harmonizimit me standardet e BE “

SHTYLLA 1

Ambient i
volitshëm afarist

SHTYLLA 2

Mësim
sipërmarrës dhe
kulturë
sipërmarrëse

SHTYLLA 3

Inovacione

SHTYLLA 4

Sektor produktiv
dhe konkurrues i
NVM

SHTYLLA 5

Financimi

7. Qellimet Strategjike

7.1 Ambienti i volitshëm afarist

Qëllimi i parë dhe themelor strategjik është krijimi i ambientit të volitshëm afarist që të sigurojë që qyteti i Shkupit do të paraqesë një ambient modern, kompetitiv dhe me orientim të volitshëm afarist, si për ndërmarrjet e vendit ashtu edhe për ndërmarrjet e huaja. Qyteti i Shkupit do ta përmirësojë koordinimin dhe integrimin e politikave të veta që i interesojnë NVM, njëherësh duke e përmirësuar mekanizmin për sigurimin e shërbimeve për zhvillim të NVM.

Qyteti do të vazhdojë t'i mbështesë APSRM dhe institucionet e tjera publike, organizatat dhe fondet që e mbështesin zhvillimin e NVM, me çka do të miratohet model për qëndrueshmëri afatgjate, si dhe koordinim dhe integrim me njësitë tjera të vetëqeverisjes vendore.

Përpjekjet e Qytetit të Shkupit për thjeshtësimin e ambientit ligjor dhe rregullues për NVM do të vazhdojnë, duke u siguruar që reformat për një ambient më të mirë afarist do qëndrojnë dhe thellohen.

Mosinformimi dhe informimi asimetrik paraqiten si problem kryesor me të cilin përballen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, startapet si dhe të gjithë qytetarët të cilët druajnë nga ardhmëria e pasigurtë në fillimin e biznesit personal. Me qëllim të zvogëlimit të ndikimit të atij problemi, do të realizohen fushata për promovimin e mbështetjes, programeve dhe trajnimeve të financuara nga Bashkimi Evropian, do të promovohet kultura sipërmarrëse, sipërmarrësia kreative, sipërmarrësia sociale si dhe ndarja e rrëfimeve të suksesshme me qëllim të inkurajimit të sipërmarrësve potencialë.

Në përputhje me rekomandimet e përcaktuara përmes pyetësorëve anketues dhe konsultimeve me njësitë e vetëqeverisjes vendore, sektorit të biznesit dhe atij joqeveritar, Qyteti do t'i shtojë konsultimet e veta dhe mekanizmat e zhvillimit të dialogut me sektorin privat. Vemendje e veçantë do t'i kushtohet përfshirjes së femrave afariste në këta mekanizma si dhe e ndërmarrjeve mikro.

Qyteti i Shkupit do ta ndjekë në mënyrë të rregullt dhe cilësore profilin e NVM (numrin e ndërmarrjeve të krijuara, punësimin, çështjet gjinore dhe shtimin e vlerës), trendet dhe barrierat. Gjithashtu do të bëhen përmirësime të mënyrës sipas së cilës Qyteti e ndjek dhe e vlerëson ndikimin e programeve dhe shërbimeve për zhvillimin e NVM. Për këtë do të jetë i nevojshëm koordinimi i ndërmjet agjencive qeveritare, siç janë Ministria e ekonomisë dhe Enti shtetëror i statistikës, Regjistri qendror, sektori joqeveritar dhe ai privat, me çka do të përmirësohet shfrytëzimi i informatave nga

ndjekja dhe informatave statistikore për vlerësimin e ndikimit të politikave dhe programeve qeveritare.

7.2 Mësimi sipërmarrës dhe kultura sipërmarrëse

Sipas vendeve anëtare të Bashkimit Evropian ekzistojnë dy mënyra për definimin e mësimi sipërmarrës, në kuptimin më të ngushtë dhe më të gjerë të fjalës. Në kuptimin më të ngushtë, qëndrimet dhe shkathtësitë sipërmarrëse kanë të bëjnë me trajnimin si të krijohet një biznes, kurse në kuptimin e gjerë, koncepti i arsimit të qëndrimeve dhe shkathtësive sipërmarrëse kanë të bëjnë me zhvillimin e cilësive personale për sipërmarrje dhe nuk është i fokusuar drejtëdrejtë në krijimin e bizneseve të reja. Ai përfshin: kreativitetin, iniciativën, marrjen e rrezikut dhe përgjegjësisë.

Arsimi sipërmarrës ndihmon që të identifikohen mundësitë që ekzistojnë në ambient, demografia e bashkësive dhe tregu i cili mund t'i mbështesë bizneset në atë sferë. Ky është proces i mësimi të përhershëm, i cili fillon nga shkollat fillore dhe vazhdon në të gjitha nivelet e arsimit. Mësohen shkathtësitë e vetërespektit dhe vetëbesimit si dhe shkathtësi për mbijetesë në botën e jashtme, me theks më të madh në pjesën praktike përkundërt asaj teorike. Zhvillohet aftësia individuale që ideja të shndërohet në aksion. Kjo përfshin kreativitetin, inovacionin dhe marrjen e rrezikut, por njëherësh edhe aftësinë për të pëanifikuar dhe udhëhequr projekte në drejtim të realizimit të qëllimeve të shtruar.

Standardet paraqesin kornizë për për të ndërtuar qëllime adekuate, aktivitete arsimore dhe vlerësime. Duke përdorur standardet, nxënësit do të kishin: aktivitete më sfiduese edukative, përvojë e cila do të mundësojë t'i zhvillojnë nevojat e brendshme për zbulimin dhe krijimin e mundësive dhe ekspertizë për fillim të suksesshëm dhe menaxhim të biznesit personal.

Zhvillimi i sipërmarrësisë, përkatësisht kulturës sipërmarrëse, është një prej temave më aktuale të së sotmes, duke marrë parasysh se zhvillimi i NVM (që janë: inovative, lehtësisht të përshtatshme ndaj ambientit të ri të krijuar afarist dhe japin mundësi për punësime të reja), ndikon ndaj tërë ambientit afarist dhe aktivitetit ekonomik të shtetit. Roli i firmave të mëdha që të sigurojnë punësim zvogëlohet dhe njerëzit gjithnjë e më shumë kërkojnë mënyrë për aftësimin e tyre në drejtim tjetër. Në afat të shkurtër, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) shihen si mënyrë me të cilën do të zgjidhej problemi me papunësinë. Në afat të gjatë, qyteti i Shkupit patjetër duhet të ndërtojë kulturë të fuqishme dhe të qëndrueshme sipërmarrëse. Kultura sipërmarrëse është kulturë e re e të jetuarit, kulturë e kultivimit të cilësive personale që e përbëjnë bazën e sipërmarrësisë: kreativitet, iniciativë, përgjegjësi, aftësi për të marrë mbi vete rrezikun.

Përmes arsimit, kultura sipërmarrëse duhet të jetë e përfshirë në jetën e fëmijëve dhe të rinjëve nga mosha më e hershme. Njëherësh duhet të rritet vetëdija te prindërit, bashkësia dhe te institucionet e arsimit se sipërmarrësia është opsion i respektuar i karrierës.

Sipas hulumtimeve të caktuara, gjysma e punëve që do të ofrohen në tregun e punës në Evropë, do të kërkojnë njerëz me kulturë të zhvilluar sipërmarrësie, njohuri financiare dhe digjitale.

Qyteti duhet ta promovojë nevojën e mësimin të sipërmarrësisë dhe ta mbështesë dhe promovojë kulturën e sipërmarrësisë. Është e nevojshme që të punohet në përmirësimin e ambientit sipërmarrës në të gjitha sferat e jetës. Bashkësia vendore ka rol të rëndësishëm në lidhjen e institucioneve arsimore me organizatat dhe firmat vendore.

Qyteti i Shkupit mund ta kultivojë kulturën e sipërmarrësisë të korporacioneve të mëdha (sipërmarrësi e brendshme ose korporative). Firmat e mëdha i vërejtën përparësitë e NVM dhe e filluan trendin e ndryshimeve të kulturës ekzistuese organizative në kulturë sipërmarrëse korporative. Ata krijojnë qendra sipërmarrëse përfitimi, e ndryshojnë qëndrimin të të punësuarit në atë sipërmarrës, nxisin besim, vetëbesim dhe kreativitet, japin liri dhe fleksibilitet, krijojnë liderë, i stimulojnë të punësuarit që të fitojnë shkathtësi të reja.

Ambienti i ndryshueshëm krijon nevojën e përsosjen së vazhdueshme dhe mësimin të përgjeshëm, jo vetëm të rinjtë por edhe të rriturit. Vizita e trajnimeve, shkollave verore, seminareve, konferencave, jep mundësi për edukimin e individëve, tanimë me përvojë në sferën e vet, të cilët duan ta mbindërtojnë diturinë e vet ose të fitojnë shkathtësi të reja. Këto shkathtësi të reja, të ashtuquajtura kompetenca themelore, përfshijnë: punë në kompjuterë, njohje të gjuhëve të huaja, të mësuarit si të mësohet, kulturë teknologjike, sipërmarrësi, shkathtësi sociale, novatorizëm dhe kreativitet. Në këtë mënyrë të rriturit aftësohen që të përballen me problemet dhe sfidat e jetës së përditshme, duke u bërë pjesë të shoqërisë së qytetarëve proaktivë dhe sipërmarrës. Shikuar në tërësi, kultura sipërmarrëse mund të ndihmojë në zhvillimin e ekonomisë. Strategjia e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrësisë e Qytetit të Shkupit (2018-2021) është bazë për krijimin e ambientit sipërmarrës.

7.3 Inovacionet

Njëri prej faktorëve më të rëndësishëm që ndikojnë më forcën sipërmarrëse të kompanive, është aftësia e tyre që të sjellin risi në prodhime e shërbime dhe në procese.

Kapacitetet inovative të NVM janë temë kyçe e konkurrencës evropiane dhe rritjes së ndërmarrjeve. Kompanitë më të vogla shpesh i përdorin mundësitë teknologjike dhe komerciale, të cilat janë lënë pas dore nga shumë kompani me renome, si faktorë të rritjes ekonomike dhe punësimit.

Megjithatë inovacionet paraqesin forcë kryesore lëvizëse në luftën për mbijetesë dhe konkurrencë të kompanive, vëllimi dhe shpejtësia e aplikimit të inovacioneve janë pasojë e një numri të madh arritjes shkencore e teknologjike dhe e impementimit të tyre në praktikë. Për këto arsye, Qyteti i Shkupit i qaset nxitjes dhe mbështetjes së veprimtarisë inovative në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për të realizuar zhvillim të shpejtuar teknologjik, të bazuar në transferin e diturisë, në hulumtimin e zhvillimit dhe të inovacioneve që i kontribuojnë krijimit të vendeve të reja të punës.

Aftësia për risi është njëri prej faktorëve më të rëndësishëm nga të cilët varet forca ekonomike e NVM. Përfitimet që dalin nga risitë e kompanive janë të shumta dhe kontribuojnë për:

- përmirësimin e produktivitetit;
- zvogëlimin e shpenzimeve;
- sigurimin e pozicionit konkurrues të tregut;
- rritjen e vlerës së brendit;
- vendosjen e partneriteteve të reja;
- rritjen e profitit dhe profitabilitetit.

Konkurueshmëria e kompanive në kushte bashkëkohore zvogëlohet si rezultat i shtimit të numrit të konkurentëve në treg dhe i dukurive të dyfishimit madje edhe të imitimit të prodhimeve tanimë ekzistuese. Së këndejmi, është veçanërisht e rëndësishme që ndërmarrjet vazhdimisht të sjellin inovacione të prodhimeve, shërbimeve dhe proceseve të tyre me qëllim që të mos ngecin prapa konkurrencës, e cila do të mund t'ua marrë rolin prijës.

7.4 Sektori produktiv dhe konkurrues i NVM (NVM produktive dhe inovative në tregun e vendit dhe pjesëmarrës konkurrues në tregjet e huaja)

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme gjithnjë e më shumë përballen me konkurrencën ndërkombëtare dhe e shqyrtojnë nevojën që t'u përshtaten ndryshimeve të mjedisit të tyre strategjik. Kjo jo vetëm që nënkupton përshtatje strategjive të tyre vendore, por gjithnjë e më tepër firmat vendosin që t'i zgjerojnë aktivitetet jashtë kufijve të vendeve të tyre. Për t'u ballafaquar me sfidat e këtyra, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme duhet të jenë të vetëdijshme se konkurrenca e rritur duket se rrënjësohet edhe në perspektivat

e brendshme edhe në ato të jashtme të punës së tyre. Si rezultat i kësaj ata duhet të kenë vëmendje në:

- Aftësitë inovative dhe aftësinë që të zhvillohen dhe apsorbohen teknologji të reja;
- Njohjen e tregjeve në të cilat shfaqen ose do të shfaqen;
- Qasjen deri te kapitali.

Ndonëse internacionalizimi mund të jetë i nevojshëm për rritjen e kompanisë për një afat të gjatë, megjithatë rreziqet dhe shpenzimet të cilat i kanë firmat në atë proces, janë të konsiderueshme. Firmat e vogla konsiderojnë se është vështirë të tejkalohen këto sfida dhe shpesh pësojnë nga madhësia e tyre e kufizuar, nga resurset e kufizuar, përballen me vështirësi në procesin e financimit të aktiviteteve të tyre ndërkombëtare, dhe gjithashtu kanë përvojë të kufizuar ndërkombëtare të ekipeve të tyre të menaxhimit.

Pikërisht për këtë, Qyteti i Shkupit, përmes mbështetjes financiare të projekteve për organizimin e trajnimeve dhe dhe shërbimeve konsulente, përmes promovimit të nevojës së certifikimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare për cilësi (ISO), do t'i nxisë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që të përmirësohen në drejtim të rritjes së aftësisë së tyre konkurruese.

Nëse ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dëshirojnë të mbeten konkurrues dhe të luajnë rol më të rëndësishëm, si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar, ata duhet vazhdimisht të përmirësohen, të rriten, ta rrisin munrin e të punësuarëve, të rrisin gamën e prodhimeve dhe shërbimeve, tregjet, e me këtë realizojnë edhe përfitim më të madh, ndërsa mjeti që do të ndihmojë në realizimin e gjithë kësaj janë standardet ndërkombëtare të cilësisë. Statistika evropiane thotë që NVM paraqesin 98% të biznesit të gjithëmbarshtëm në Evropë dhe punësojnë më shumë se 90 milionë njerëz. Përkundër kësaj, është pak e besueshme që NVM do të kycen në mënyrë aktive në procesin e zhvillimit të standardeve, për dallim nga kompanitë e mëdha. Për t'u siguruar që standardet i kënaqin nevojat e kompanive të vogla, është e nevojshme që NVM-ve t'u sigurohen informata për aktivitetet e standardizimit e, njëherësh, që interesat e tyre janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate gjatë zhvillimit, përgatitjes dhe rishqyrtimit të standardeve.

Shumica e barrierave me të cilat ballafaqohen NVM, janë në nivel të ekonomisë nacionale, institucioneve dhe infrastrukturës së përgjithshme. Politika e konkurrencës, korniza legjislative dhe rregulluese, infrastruktura e telekomunikimit, politika hulumtuese dhe arsimore, të gjitha këto i kontribuojnë gatishmërisë ose jogatishmërisë së NVM-ve për pjesëmarrje në globalizimin.

Sa u përket rrjetave inovative, masat jo stimuluese dhe pengesat për rrjetëzim nga ana e NVM-ve paraqiten në tre lloje vështirësish edhe atë:

- Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet NVM me çka zvogëlohet qarkullimi dhe këmbimi i informatave si dhe dituria e fshehur, në dëm të inovacioneve jo teknologjike (në fushën e tregut të inteligjencës, dizajnit, brandimit dhe zhvillimit të resurseve njerëzore);
- Ndërveprimi i pamjaftueshëm ndërmjet firmave me teknologji të lartë në dëm të inovacioneve teknologjike dhe difuzionit teknologjik;
- Zhbalancimi gjeografik në bashkëpunimin ndërkombëtar të modeleve.

Qyteti i Shkupit ka rol të madh në korrigjimin e zhbalancimit të tillë me:

1. sigurinë që programet e tyre promovuese do t'u mundësojnë pjesëmarrësve nacionale qasje në rrjetet ndërkombëtare;
2. Zhvillimin e dimensionit ndërkombëtar të partneritetit publik-privat.

Për t'u shmangur mosharmonizimi ndërmjet dimensionit të fuqishëm rajonal të shumicës së rrjeteve të vetëorganizuara të NVM, shtrirjes nacionale të një numri të madh të programeve për promovimin e tyre, rritjes së njohjes sëinfrastrukturës globale dhe tregjeve për prodhime inovative dhe shërbime, është i nevojshëm bashkëpunimi ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe NVM. Kjo përfshin ndërveprimin ndërmjet qendrave lokale për transferin e teknologjisë, duke lidhur rrjetet nacionale të NVM me nevoja dhe aftësi komplementare të ngjashme, ndërtimin e rrjeteve globale të organizatave ndërmjetësuese dhe koordinimin e programeve të përkrahjes.

7.5 Financimi

Qasja në financa ka rëndësi kyçe për themelimin, qëndrueshmërinë, rritjen dhe zhvillimin e biznesit të NVM. Si burime të preferuara financimi të rritjes së kompanive evropiane shfrytëzohen kreditë bankare. Megjithatë, problemi më serioz me të cili përballen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme është pikërisht qasja në burimet përkatëse të financimit. Investuesit dhe bankat shpesh janë të përmbajtura në financimin e ndërmarrjeve dhe biznese të vogla të reja për shkak të pranisë së theksuar të rrezikut.

Pikërisht për këtë, Qyteti i Shkupit si qytet që promovon aktivitet të qëndrueshëm ekonomik dhe dhe aftësi konkurruese dhe institucion të besueshëm, i mbështet NVM përmes ndarjes së ndihmës së llojllojshme dhe përmes informimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe startapeve për kushtet e volitshme dhe mundësitë e aplikimit të forndet evropiane dhe BIE.

Komisioni evropian e ndihmon aktivisht investimin në biznese nismëtare ndërsa mjetet distribuohen nëpërmjet institucioneve financiare, më shpesh nëpërmjet bankave. Banka Investuese Evropiane e zgjeron mënyrën e mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes thjeshtimit të mekanizmave të veta të financimit, duke i bërë më transparente dhe më mirë të orientuara kah nevojat konkrete të bizneseve të vogla gjithandej Evropës.

Kredia e Bankës Investuese Evropiane është në dispozicion edhe për kompanitë nga R. e Maqedonisë përmes Bankës maqedonase për mbështetje të zhvillimit që përbëhet prej tre prodhimeve:

- Kredi investuese për ndërmarrje të vogla dhe të mesme,
- Kredi për mjete të përhershme qarkulluese dhe
- Kredi për projekte parësore .

Banka Investuese Evropiane, gjithashtu, e zgjeron veprimin e vet edhe në fusha të reja financimi, siç janë instrumentet jo financuese- investim në hulumtim dhe zhvillim, vendosja e rrjetit shpërndarës ose sigurimi i vazhdimësisë së biznesit.

Komisioni Evropian konsideron që promovimi i NVM ka rëndësi të jashtëzakonshme. Aktivitetet e shumta të saj janë të lidhura me mbulimin e “Aktiviteteve të biznesit të vogël” në Evropë, përmirësimin e ambientit afarist, promovimin e sipërmarrësisë, lehtësimin e qasjes në tregjet dhe përhapjen e praktikave të mira.

Duke pasur parasysh faktin që tregjet financiare nuk arrijnë ta sigurojnë mbështetjen e nevojshme për NVM, Komisioni Evropian ndihmon në mënyrë aktive investimin e biznese të reja ndërsa mjetet shpërndahen përmes institucioneve financiare, më shpesh përmes bankave. Instrumentet financiare të cilat paraqiten në formë të mbështetjes, mbështetjes garantuese, mikro kredive dhe financimit mezanin (të përzier), janë mbështetur me buxhetin e Bashkimit Evropian dhe mbulojnë nevoja të ndryshme të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, pa marrë parasysh a është fjala për kompani të reja ose kompani tanimë ekzistuese.

Ndonëse nuk ekziston program për mbështetje të drejtpërdrejtë të rritjes së lartë të NVM inovative nga ana e Komisionit Evropian, ekziston Programi evropian “Eurostars”. “Eurostarsi” bashkërisht e vënë në lëvizje nga platforma Eureka për mbështetjen e aktiviteteve për hulumtime dhe zhvillim. Programi “Eurostars” është programi i parë evropian financim dhe mbështetje, i cili ka një dedikim special ndaj NVM, me qëllim që “t’i mbështesë sipërmarrësit më efektivë, të kryejë financimin e aktiviteteve të tyre hulumtuese dhe zhvillimore, duke u mundësuar të garojnë në nivel ndërkombëtar dhe të bëhen liderë në sektorin e tyre”.

8. Implementimi, kontrolli, masat korigjuese dhe revizioni i Strategjisë

Strategjia për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrësisë të qytetit të Shkupit ka një kohëzgjatje prej 4 vitesh (vitet 2018-2021). Për implementimin e saj do të kujdeset Qyteti i Shkupit, përkatësisht Sektori për zhvillim lokal ekonomik së bashku me sektorët e tjerë në Qytetin e Shkupit. Për realizim të suksesshëm të Strategjisë, pas miratimit të saj dhe hyrjes në fuqi, Qyteti i Shkupit do të fillojë realizimin e një pjese të projekteve të parashikuara me Planin e Aksionit si dhe përcaktimin e mjeteve të nevojshme.

Në përpunimin e Strategjisë pjesë të rëndësishme kishte puna e grupit të punës të përbërë nga të gjithë aktorët në qytetin e Shkupit, të rëndësishëm për sektorin e sipërmarrësisë dhe NVM.

Në Strategji janë inkorporuar perceptimet e tyre për gjendjen aktuale në sferën gjegjëse, nevojat dhe pritjet e tyre për mbështetje dhe kahet e zhvillimit si dhe gatishmëria e Qytetit të Shkupit t'u dalë në ndihmë kërkesave të tyre. Ndjekja e statusit të realizimit të Strategjisë dhe Planit të aksionit do të bëhet përmes roleve dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë të bartësve dhe shfrytëzuesve të masave dhe aktiviteteve konkrete si dhe obligimit të tyre për dhënien në kohë të informatës kthyesë të përgjegjësve për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të definuara si dhe nevojave për harmonizime dhe ndryshime eventuale të Strategjisë dhe Planit të aksionit. Bartës i procesit të përgatitjes dhe realizimit të Strategjisë dhe Planit të aksionit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për periudhën e viteve 2018-2021 është Qyteti i Shkupit, përkatësisht Sektori për zhvillim ekonomik lokal të Qytetit të Shkupit.

Revizioni dhe kontrolli i rregullt përmes mbajtjes së mbledhjeve në nivel të grupit të punës nën koordinimin e Qytetit të Shkupit, përkatësisht Sektorit për zhvillimin ekonomik lokal e nën patronazhin e prefektit të Qytetit të Shkupit, janë kyçe për ndjekjen e realizimit dhe implementimit të Strategjisë. Për implementimin e suksesshëm të kësaj Strategjie është veçanërisht e rëndësishme që të sigurohen resurset e nevojshme, e para së gjithash, mjetet financiare të parashikuara në Planin e aksionit dhe në atë financiar. Për këtë qëllim, është e nevojshme që Qyteti t'i fusë mjetet e nevojshme, për realizimin e projekteve nga Plani i aksionit, në buxhetet e veta vjetore, ndërsa për vitin 2018 të përgatisë një ribalac buxheti, me çka do të sigurohen mjetet e nevojshme dedikuar realizimit të projekteve të parashikuara për vitin 2018. Qyteti i Shkupit, duke pasur parasysh se një numër i madh projektësh në planin e aksionit, kanë më shumë burime financimi (për shkak të pamundësisë së Qytetit që t'i sigurojë të gjitha mjetet e nevojshme për realizimin e tërë Strategjisë), nevojitet që në mënyrë proaktive, të planifikuar dhe në bashkëpunim të të gjithë sektorëve të Qytetit e nën koordinim të Sektorit të zhvillimit ekonomik lokal, Sektori i bashkëpunimit

ndërkombëtar dhe Sektori i financave, të punojë në gjetjen e mjeteve financiare nga burime të tjera (nga organizata vendore dhe ndërkombëtare, agjenci zhvillimore, fonde evropiane e fonde të tjera etj.) për realizimin e kësaj Strategjie. Për çdo projekt të përmendur në këtë strategji Qyteti i Shkupit, pas miratimit të strategjisë është e nevojshme të shpall thirrje për zbatuesit e çdo projekti veç e veç të përfshirë në Planin e aksionit.

Realizimi i strategjisë varet edhe nga faktorët e jashtëm edhe nga ata të brendshëm të cilët kanë rëndësi kyç për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe sipërmarrësin në qytetin e Shkupit. Në përputhje me këtë, nevojat, prioritetet, masat dhe aktivitetet në Strategji mund të pësojnë ndryshime. Këta ndryshime do shqyrtohen dhe lejohen në takimet e rregullta tremujore të grupit të punës.

9. Plani i aksionit

Propozimprojektet e theksuara të cilat janë pjesë përbërëse e Planit të aksionit të Strategjisë për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrësi për vitet 2018-2021 janë vendosur me qëllim që të kenë efekte të shumëfishta në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë.

E para, do të rritet numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) të cilat janë forcë lëvizëse e një numri të madh të ekonomive. NVM janë punëdhënësit më të mëdhenj në Evropë, në Maqedoni ata punësojnë 80% të fuqisë punëtore.

E dyta, me rritjen e numrit të të punësuarëve ose të vetëpunësuarëve, do të zvogëlohet papunësia si dhe do të nxitet sipërmarrësia kreative, kultura sipërmarrëse do të jetë e përhapur gjerësisht dhe e disponueshme për të gjithë qytetarët, me qëllim përfundimtar krijimin e kuadrit konkurrues i cili mund t'u përgjigjet sfidave globale. Gjithashtu, edhe të punësuarit në administratën publike do të kenë orientin sipërmarrës dhe do të jenë të gatshëm t'u përgjigjen sfidave të cilat prej tyre do t'i presin investuesit e ardhshëm të jashtëm dhe të vendit.

Plani i aksionit për periudhën prej vitit 2018 deri në vitin 2021

Shtylla – 1 – Ambienti afarist

Qëllime, masa dhe projekte	Vlerësim përfundimtar / P R I O R I T E T E	Përshkrim i shkurtër Qëllimet dhe grupet e synuara /shfrytëzues (beneficiary)	Periudha e implementimit / korniza kohore/ afatet	Rezultate të pritura	Konstrukt. Financiar (shuma), shpenzime për resurse të domos- doshme
1. Inkubatorë biznesi	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Ndihmë gjatë menaxhimit, ndihmë gjatë planifikimit dhe ndihmë financiare si dhe ndihmë gjatë: • Menaxhim me fonde të veta, hua revolving dhe hua për firma të vogla, • Lidhja e kompanive me investitorë (e ashtuquajtur business angels) • Punë me venture capitalists lidhja e firmave nga inkubatori me ata burime formale të investimit • Ndihmë kompanive gjatë aplikimit për kredi bankare Diseminim i gjerë i informatave të dobishme, fushata promovimi të vetëpunësimit, mbështetje gjatë formimit të biznesit vetjak. <u>Qëllimi:</u>	Në vazhdimësi deri në 2021	Numër i shtuar i NVM të reja Numër i shtuar i punësimeve të reja në NVM	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



		Krijimi i vendeve të reja të punës, rigjallërim i fqinjësisë dhe promovim i teknologjive të reja, duke e forcuar me këtë rast ekonominë vendore, rajonale dhe nacionale. <u>Grupet e synuara/ bartësit:</u> Sipërmarrës të cilët duan të fillojnë biznes të ri përmes hapjes së NVM Qyteti i Shkupit			
2. Këshill afaristësh (në nivel komunash)	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Formimi i Këshillit të afaristëve/ Qyteti i Shkupit, të cilët rregullisht do të mbledhin informata për vështirësitë me të cilat përballen NVM, si dhe propozimet e tyre për përparimin e punës. <u>Qëllimi:</u> Identifikimi i problemeve dhe vështirësive me të cilat përballen kompanitë nga komunat me qëllim që të përmirësohet klima e biznesit. <u>Grupet e synuara/ bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Qyteti i Shkupit Komunat në qytetin e Shkupit	Fundi i vitit 2018	Gjurmim në kohë të duhur dhe më i mirë i vështirësive me të cilat përballen NVM dhe realizimi i masave të propozuara për përparimin e kushteve të punës të NVM	
3. Qendra afariste start-ap në të gjitha komunat	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Hapje e qendrave afariste start-ap, si ndihmë për hapjen e NVM të reja në vitet e para të fillimit të biznesit. Vendosja e rrjetit për mbështetjen e bizneseve start-ap për të rinj dhe nxitja e sipërmarrësisë me hapjen e vendeve të reja të punës. Qasje në informata, mbështetje dhe këshilla nga profesionistë, qasje te klientët	Qershor i vitit 2019	Numër i shtuar i NVM të reja Numër i shtuar i punësimeve të reja në NVM	

		potencialë dhe mundësi për prezantimin e ideve vetiake. Diseminim i gjerë i informatave të dobishme, fushata promovimi të vetëpunësimit, mbështetje gjatë formimit të biznesit vetjak. <u>Qëllimet:</u> Mundësimi i rrethana lehtësuese për fillimin e NVM të reja, përmes sigurimit të hapësirës afariste, kontabilitetit, arkivit, mirëmbajtjes dhe mbështetjes tjetër falas, gjatë hapjes së bizneseve të reja. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Sipërmarrës të cilët dëshirojnë të nisin biznes të ri përmes hapjes së NVM Qyteti i Shkupit Komunat e qytetit të Shkupit			
4. Nxitje e bashkëpunimit ndërmjet qytetit të Shkupit ndërmjet qytetit të Shkupit dhe kompanive private në projekte për zvogëlimin e ndotjes së ajrit, nxitjen e transportit të gjelbër	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Lehtësime dhe lirime të parashikuara nga Qyteti i Shkupit për NVMtë cilat do të përfshihen në iniciativat për zvogëlimin e ndotjes të mjedisit jetësor. Informata dhe konkurse të Qytetit të Shkupit për zgjedhjen e kompanisë më ekologjike dhe kontributit më të madh në mbrojtjen e mjedisit jetësor. Promovim më i madh për aplikimin e elektro-mobiliti. Stimulimi i NVMpër implementimin e standardit ndërkombëtar për mbrojtjen e mjedisit jetësor- ISO 14001:2015 dhe standardit për efikasitet energjetik ISO 5000:2011. <u>Qëllimi:</u>	Në vazhdimësi deri në 2021	Përparimi i cilësisë së jetesës përmes zvogëlimit të ndotjes	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



		Sigurimi i mbështetjes financiare për NVM të cilat punojnë në përmirësimin e profilit të tyre ekologjik dhe në përmirësimin e mjedisit jetësor dhe punues. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme në territorin e Qyteti i Shkupit Komunat e qytetit të Shkupit			
5. Ngjarje për rrjetëzim, realizim i takimeve B2B dhe formimi i partneriteteve	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> B2B – këmbimi i prodhimeve, shërbimeve dhe informatave ndërmjet ndërmarrjeve, me qëllim- zvogëlimin e shpenzimeve, rritjen e transparencës në punë, qasjen më të lehtë të tregjet e reja dhe zhvillim të metodave të reja të transaksionit. <u>Qëllimi:</u> Njohje ndërmjet kompanive, këmbim kontaktesh dhe shfrytëzim i mundësive të bashkëpunimit. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Oda ekonomike Shoqata të NVM	Në vazhdimësi deri në 2021	Shfrytëzimi i mundësive të reja afariste për bashkëpunim Përparimi i biznesit të NVM	
6. Trajnime të specializuara për programe konkrete (Horizonti 2020, Instrumenti NVM)	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Bashkëpunim përmes projekteve përkatëse, konferencave, trajnimeve, punëtorive, seminareve, forumeve, vizitave studimore, forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve akademike dhe industrisë, në drejtim të arritjes së rezultateve konkrete.	Në vazhdimësi deri në 2021	Shfrytëzim më i madh i mjeteve financiare përmes programeve konkrete dhe instrumenteve financiare	

		Financim i projekteve për hulumtim dhe inovacione, mobilitet hulumtuesish, forcim i rrjeteve ndërkombëtare, fitim i njohurive të reja dhe ekspertizës si dhe bashkëfinancim i aktiviteteve të caktuara në sektorin publik.¹ <u>Qëllimi:</u> Informim dhe njohje më e mirë e NVM për mundësitë e shfrytëzimit të mjeteve financiare përmes aplikimit me projekte përkatëse. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Institucione përmes të cilave realizohen instrumentet financiare			
7. Promovimi i rajonin dhe tërheqja e investuesve të vendit dhe të jashtëm;	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Prezantimi profesional i përfitimeve sektoriale specifike dhe operacionale të cilat Republika e Maqedonisë ua ofron investuesve dhe eksportuesve, në drejtim të stimulimit të investimeve dhe eksportit. <u>Qëllimi:</u> Krijimi i ambientit të volitshëm afarist përmes krijimit të mundësive të reja të bashkëpunimit me kompani të vendit dhe të huaja. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Agjencia për investime të huaja dhe promovim të eksportit të RM	Në vazhdimësi deri në 2021	Mundësi të shtuara për hapjen e bizneseve të reja të NVM dhe bashkëpunimin ndërmjet NVM dhe kompanive vendore dhe të huaja Зголемени	
8. Favore për sipërmarrësinë e	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u>	Në vazhdimësi deri në 2021	Inkorporim më i madh në sistemin e	

¹ <http://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/>

femrave dhe atë sociale		Përkrahja e femrave sipërmarrëse për rrjetëzim, eksport dhe klastering, si dhe lidhje me institucionet dhe organizatat civile. Krijimi i vlerës, e cila bëhet përmes mënyrës inovative të veprimit, përkushtimit drejt rritjes së mirëqenies, duke i ndihmuar ata të cilëve u nevojitet ndihma dhe mbështetja. Riinvestimi për arritjen e ndryshimit konkret shoqëror. Ofrimi i qasjeve inovative për zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar, sigurimin e të mirave dhe shërbimeve për bashkësitë e marginalizuara dhe të pazhvilluara dhe punësimin e personave nga grupet e rrezikuara përmes shfrytëzimit të fondeve të disponueshme IPA dhe të tjera të BE. <u>Qëllimi:</u> Inkorporim më i madh në sistemin e vetëpunësimit dhe punësimit të femrave dhe njerëzve të kategorive sociale në rrezik. <u>Grupet e synuara/bartësit :</u> Ministria e punës dhe politikës sociale Programet për financim nga Bashkimi Evropian Institucionet qeveritare dhe joqeveritare NVM të drejtuara nga femrat sipërmarrëse Femra dhe njerëz nga kategoritë esociale në rrezik		vetëpunësimit dhe punësimit të femrave dhe njerëzve në rrezik social	
9. Këmbimi i përvojave, praktika të mira dhe rrëfime të suksesshme sipërmarrësie ndërmjet vendeve	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Zhvillimi i rrjetëzimit të biznesit (realizim i kontakteve, partneritetit, forumeve dhe rrjeteve për këmbimin e përvojave dhe diturisë); organizimi i trajnimeve për nevoja specifike; zhvillimi i kapaciteteve të mentorimit dhe programeve të mentorimit.	Në vazhdimësi deri në 2021	Përvoja dhe mundësi të fituara pozitive për bashkëpunim të NVM me kompani vendore dhe të jashtme	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



nga rajoni dhe Bashkimi Evropian		<u>Qëllimi:</u> Stimulimi i kulturës sipërmarrëse dhe këmbimi i praktikave të mira dhe diturisë me BNVM nga vende të tjera. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Oda ekonomike Agjenci/ministri			
10. Thëllimi i bashkëpunimit të Qytetit të Shkupit dhe komunave me Fondacionin për zhvillimin e NVM	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Vendosja e komunikimit të rregullt me Fondacionin për zhvillimin e NVM, në drejtim të sigurimit në kohë të informatave të nevojshme për NVM dhe mundësitë për zhvillimin e tyre të vazhdueshëm. <u>Qëllimi:</u> Intensivimi i bashkëpunimit institucional të Qytetit të Shkupit dhe komunave me Fondacionin për zhvillimin e NVMonin për zhvillimin e NVM, në drejtim të sigurimit të mbështetjes së shtuar të NVM. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Qyteti i Shkupit Fondacioni për zhvillimin e NVM	Në vazhdimësi deri në 2021	Sigurim i mbështetjes së rritur të NVM.	
11. Promovimi i partneriteti publik-privat në Qytetin e Shkupit dhe komunat	18	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Vendosja e partneriteteve publik-privat (PPP) në drejtim të realizimit të ndërtimit të shpejtuar të infrastrukturës, shërbimeve publike më cilësore, efikasitetit të rritur (shpenzime të zvogëluara në ciklin jetësor të projektit), ndarjes më të mirë të rreziqeve, implementimit më të mirë të projektit etj..	Në vazhdimësi deri në 2021	Implementim i shtuar dhe më efikas i projekteve infrastrukturore	

		<u>Qëllimi:</u> Realizim proporcional dhe më i thjeshtë i projekteve prioritare infrastrukturore, përmes vendosjes së partneritetit publik-privat. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Qyteti i Shkupit Komunat në Qytetin e Shkupit			
12. Parku teknologjik	18	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Hapja e parkut teknologjik me të cilin do të mundësohet ndihma për zhvillimin teknologjik të kompanive ekzistuese dhe atyre startup, tërheqjen e kapitalistëve venture dhe të ëngjujve të biznesit. <u>Qëllimi:</u> Vendosja e sistemit të mentorizmit dhe diturisë përmes të cilit do të stimulohet hapja e NVM të reja inovative, të cilave do t'u mundësohet investim dhe mbështetje për realizimin e idesë së tyre të biznesit. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Grupi i punës i përbërë nga odat, nga bashkësia e biznesit, MASIT, bashkësia akademike dhe të gjitha universitetet e interesuara, fondi i inovacioneve dhe zhvillimit teknologjik dhe Qeveria.	Mesi i vitit 2019	Hapja e NVM të reja inovative. Zhvillim i kuadrove të reja TIK të cilët do të mbeten këtu që të punojnë në këta inovacione. Promovimi i Maqedonisë si burim inovacionesh dhe zgjidhjes inovative.	
13. Dita evropiane e sipërmarrësit	18	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Organizim dhe mbajtje e vazhdueshme e "Ditës Evropiane të sipërmarrësit dhe Javës evropiane të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme".	Në vazhdimësi deri në 2021	Promovim i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si lëvizës kryesorë	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



		<u>Qëllimi:</u> Promovimi i sipërmarrësisë, kreativitetit dhe novatorizmit si dhe informimi i sipërmarrësve për mbështetjen që u ofrohet përmes formave të ndryshme për zhvillimin e tyre dhe programeve të BE. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Qyteti i Shkupit Ndërmarrje të vogla dhe të mesme		të rritjes dhe zhvillimit ekonomik	
14. Përfshirja e përfaqësuesve nga sektori privat në projekte evropiane në të cilat Qyteti i Shkupit është partner	18	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Në projektet evropiane në të cilat Qyteti i Shkupit është partner, është e nevojshme përfshirja e sektorit privat me qëllim që në mënyrë më efektive dhe më efikase tu përgjigjen aktiviteteve të projekteve evropiane. Në këtë mënyrë sektori privat do të ndihmojë në realizimin e aktiviteteve dhe Qyteti i Shkupit do të jetë më konkurrues ndër qytetet evropiane për të konkurruar në projektet e BE. <u>Qëllimi:</u> Inicimi i projekteve të reja nga sektori privat dhe rrjetëzimi i tyre me partnerë të huaj. <u>Grupet synuara/bartësit:</u> Qyteti i Shkupit Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	Në vazhdimësi deri në 2021	Realizim më efektiv dhe më efikas i projekteve evropiane	
15. Promovimi i mundësive për punë në sektorin social ose themelimi i	18	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Promovimi i mundësive për themelimin e bizneseve në sektorin social, përkatësisht shërbime të reja për persona të moshuar,	Në vazhdimësi deri në 2021	Themelimi i bizneseve të reja në sektorin social	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



bizneseve në këtë sektor		ruajtjen e fëmijëve, njerëzve me nevoja të veçanta etj. Sigurimi i informimit më të madh për mundësitë dhe benifitet afatgjatë për tërë ekonominë dhe përfshirja sociale e këtyre kategorive të njerëzve. <u>Qëllimi:</u> Ngritja e vetëdijes për nevojën e themelimit të bizneseve të reja në sektorin social. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Qyteti i Shkupit Ndërmarrje të vogla dhe të mesme			
16. Forume biznesi, panaire lokale të biznesit	12	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Organizimi i Forumeve të biznesit, panaireve dhe ngjarjeve të tjera, në drejtim të këmbimit të kontakteve dhe rrjetëzimit ndërmjet kompanive, përmes njohjes së drejtpërdrejtë dhe bisedave me furnizuesit dhe shpërndarësit potencialë, me investuesit dhe këshilluesit në tema që janë në interes për punën e kompanive dhe për hapjen e mundësive të reja për bashkëpunim afarist. Inicim i bashkëpunimit ndërmjet NVM të cilat punojnë në rajonin e Shkupit – zhvillim i zinxhirit lokal të prodhimit. <u>Qëllimi:</u> Relizimi i mundësive të reja të bashkëpunimit afarist, përmes zgjerimit të rrjetit të kontakteve afariste në vend, në ranon dhe në përmasa globale. <u>Geupet e synuara/bartësit:</u> Odat ekonomike	Në vazhdimësi deri në 2021	Realizimi i mundësive të reja për bashkëpunim afarist ndërmjet kompanive	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



		Shoqatat e NVM Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme			
17. Lehtësimi apo thjeshtimi i shërbimeve të Qytetit të Shkupit dedikuar NVM ose vendosja e shërbimeve të reja	8	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Thjeshtimi i shërbimeve përmes digjitalizimit, shkurtimeve të procedurave. Identifikimi i nevojave të NVM përmes hapjes/qasjes në një pjesë të të dhënave (regjistra të hapura për kompanitë, të dhëna me rëndësi për NVM) të qytetit të Shkupit, me qëllim të krijimit të shërbimeve të reja nga sektori privat. <u>Qëllimi:</u> Qasje më e lehtë në shërbimet ekzistuese dhe vendosja e shërbimeve të reja nga Qyteti i Shkupit dedikuar NVM. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Qyteti i Shkupit NVM	Në vazhdimësi deri në 2021	Shërbime të reja të futura në përputhje me nevojat e NVM Qasje më e lehtë të shërbimet ekzistuese dedikuar NVM	
18. Trajnime dhe konsultime për planifikim të biznesit dhe hartimin e planit të biznesit	8	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Organizimi i trajnimeve të specializuara dhe konsultimeve për NVM, sa u përket planifikimeve të biznesit përgatitjes së planeve të biznesit. <u>Qëllimi:</u> Rritja e suksesit në realizimin e ideve të biznesit, përmes planifikimit adekuat dhe në kohë të biznesit dhe përpunimit të planeve cilësore të biznesit. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Odat ekonomike Kompani këshillimi Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	Në vazhdimësi deri në 2021	Rritja e numrit të ideve të biznesit të realizuara me sukses përmes planifikimit cilësor dhe në kohë të biznesit.	

19. Panairë virtuale dhe/ose oflajn të mbështetësve të bashkësisë start-ap në nivel vendor dhe nacional	8	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Organizimi i panairëve virtuale dhe/ose oflajn të mbështetësve të bashkësisë start-ap në nivel vendor dhe nacional, në drejtim të këmbimit të kontakteve dhe rrjetëzimit ndërmjet kompanive si dhe hapjes së mundësive të reja të bashkëpunimit afarist. <u>Qëllimi:</u> Hapja e mundësive të reja të bashkëpunimit afarist, përmes zgjerimit të rrjetit të kontakteve afariste të mbështetësve të bashkësisë start-ap në nivel vendos dhe nacional <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Odat ekonomike Shoqata të NVM Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	Në vazhdimësi deri në 2021	Realizim i mundësive të reja për bashkëpunim afarist ndërmjet mbështetësve të bashkësisë start-ap në nivel lokal dhe nacional.	
20. Shfrytëzimi i rrjetit evropian të mundësive të biznesit http://een.mk/	8	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Shfrytëzim i vazhdueshëm i rrjetit të mundësive të biznesit, i cili ka për qëllim të ofrojë të gjitha format e mbështetjes afariste të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në rrugën e tyre drejt tregjeve evropiane, përmes dhënies së mundësive dhe ndihmës ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për shfrytëzimin e mundësive të ndryshme të biznesit në kuadër të tregut unik të BE, duke zhvilluar aktivitete bashkëpunimi nga sfera e biznesit, teknologjisë ose shkencës. <u>Qëllimi:</u> Informim më i madh i NVM për mundësitë e mbështetjes së bizneseve inovative dhe për	Në vazhdimësi deri në 2021	Shfrytëzim më i madh i rrjetit evropian të mundësive të biznesit	

		qasjen deri te financat dhe programet e financimit nga ana e Bashkimit Evropian. <u>Grupet e synuara/bartësit :</u> Qendra evropiane informative dhe inovative në Maqedoni (QEIM) Universiteti "Sh. Kirili dhe Metodi" në Shkup Fondacioni i menaxhmentit dhe hulumtimit industrial, Oda ekonomike e Maqedonisë, Lidhja e odave ekonomike të Maqedonisë.			
21. Promovim i ndërmarrjeve sociale si mundësi për hapjen e vendeve të reja të punës për personat e marginalizuar dhe personat në rrezik social	8	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Sipërmarrësi sociale luan rol të rëndësishëm në sfidat sociale, ekonomike dhe ekologjike e njëherësh siguron rritje inkluzive për prosperitet të përbashkët dhe inkluzion social. Gjenerimi i ideve, propozimeve dhe rekomandimeve për nxitjen e sipërmarrësisë nëpërmjet definimit të sfidave prioritare drejt të cilave duhet të orientohet: zgjidhja e problemeve sociale dhe ekologjike, forcimi i rritjes inkluzive, integrimi i pakicave etnike, masat dhe kuotat për mbështetjen e ndërmarrjeve sociale. Futja e lehtësimeve administrative dhe tatimore për ndërmarrjet sociale të cilat do të punësojnë persona që janë përfaqësues të grupeve në rrezik social. <u>Qëllimi:</u> Sigurimi i rritjes inkluzive për prosperitet të përbashkët dhe inkluzion social përmes rritjes së vendeve të reja të punës për	Në vazhdimësi deri në 2021	Vende të reja pune të për personat e marginalizuar dhe personave në rrezik social	

		persona të marginalizuar dhe persona në rrezik social. <u>Grupe të synuara/bartës:</u> Ministria e punës dhe e politikës sociale Programet e financimit nga Bashkimi Evropian Ndërmarrje të vogëa dhe të mesme Institucione qeveritare dhe joqeveritare			
22. Themelimi i fondit të qyteti ku kompanitë e mëdha do të dhurojnë mjete vjetore të cilat do të përdoren për mbështetjen e kompanive të reja startup	4	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Ndihmë financiare nga kompanitë e mëdha për mbështetjen e kompanive të reja startup. Çdo kompani e cila do të dhurojë mjete në këtë fond do të fitojë njëfarë lehtësimi nga qyteti- tatime, komunaliet etj. Menaxhim nga ana e ndonjë organizatë joqeveritare ose trupi që do ta themelojë qyteti, ku në llogarinë e dhurimit do të pranohet ndihma financiare <u>Qëllimi:</u> Sigurimi i mbështetjes financiare për NVM të reja, përmes shpërndarjes së ndihmës financiare të fituar nga kompanitë e mëdha. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Qyteti i Shkupit Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Kompani të mëdha	Mesi i vitit 2019	Rritja e burimeve alternative të financimit të NVM të reja	
23. Zvoglimi i tatimit ose komunaleve nga ana e Qytetit të Shkupit për çdo NVM e cila do të promovojë	4	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Aplikimi i lehtësimeve konkrete (zvogëlim i tatimit os komunaleve) në drejtim të stimulimit të inovacionit të NVM për zhvillimin e prodhimeve dhe shërbimeve, në bazë të hulumtimeve shkencore dhe praktike në	Fundi i vitit 2018	Rritje e novatorizmit dhe futja e prodhimeve/shërbimeve të reja nga ana e NVM	

prodhim ose shërbim të ri në treg		bashkëpunim me fakultetet/qendra hulumtimi. <u>Qëllimi:</u> Rritja e aftësisë konkurruese dhe e potencialit eksportues të NVM vendore në tregun e jashtëm, përmes stimulimeve të inovacioneve dhe bërjes së prodhimeve/shërbimeve të reja. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Qyteti i Shkupit Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Fakultete Qendra hulumtimi		Shtimi i aftësisë konkurruese dhe potencialit eksportues të NVM vendore në tregun e jashtëm	
24. Promovim plotësues i profesioneve të reja	1	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Promovim i profesioneve të reja –analizues për vlerësim të ndikimit të projekteve shoqërore (SROI – social return of investment), sipërmarrës social, profesione të reja nga sfera e inovacioneve, industritë kreative, profesione që i ngërthejnë zejet e vjetra me teknologjinë moderne, vende të gjelbra pune etj. <u>Qëllimi:</u> Stimulimi i profesioneve të reja, me të cilat do të rritej përparësia konkurruese e NVM dhe vetëdija për përgjegjësi të rritur shoqërore. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Qyteti i Shkupit Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	Mesi i vitit 2019	Zhvillimi i profesioneve të reja inovative	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



25. Portal informativ biznesi		<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Disejnimi, menaxhimi dhe mbajtja Web portalit të bazuar interaktiv të NVM në territorin e qytetit të Shkupit “Bussiness@your portal “ i cili do të shpërndajë dhe prezantojë të dhëna themelore për NVM nga territori i Shkupit, me të dhëna për veprimtari, strukturë organizative, tregues financiarë për plane investimi etj. Gjithashtu, do t'i prezantojë kërkesat për partneritet për projekte të reja inovative, interes për teknologji të reja, vënie në dispozicion të kapaciteteve etj. <u>Qëllimi:</u> Krijimi i Web portalit për NVM i cili do të shpërndajë dhe prezantojë të dhëna themelore për NVM nga territori i Shkupit. <u>Grupe të synuara/bartës:</u> NVM nga Shkupi Oda ekonomike dhe të degëve Universitete dhe fakultete	Mesi i vitit 2019	Themelimi i Web portalit i cili do të shpërndajë dhe do të prezantojë të dhëna themelore për NVM nga territori i Shkupit.	
26. Formimi i rrjetit të qyteteve partnere në biznes		<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Formimi i rrjetit të qyteteve partnere në biznes Rrjeti i qyteteve partnere në biznes të jetë lloj i ri i partneriteteve të krijuara strategjike ndërmjet institucioneve nga qyteti i Shkupit dhe nga qytetet partnere. Propozimi është që ato të jenë institucionet të cilat e promovojnë zhvillimin lokal dhe rajonal: - Agjencitë për zhvillim lokal dhe/ose - Institucionet për mbështetjen e sektorit të biznesit	Mesi i vitit 2019	-Pjesëmarrës të mundshëm të definuar në Forumin e biznesit të qyteteve partnere të Qytetit të Shkupit. -Formimi i Rrjetit të partnerëve bashkorganizatorë Forumit portall për lidhjen e firmave dhe	

		<u>Qëllimi:</u> Promovimi dhe nxitja e bashkëpunimit ekonomik të Qytetit të Shkupit me qytetet e vëllazëruara, qytetet partnere dhe nënshkruese të formave të ndryshme të nga Bashkimi i kryeqyteteve të Evropës Qendrore dhe Juglindore, Bashkimi ballkanik i qyteteve, nga Evrorajoni “Ballkan” etj. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Qyteti i Shkupit, komunat e territorit të Qytetit të Shkupit dhe komunat e qytetet e tyre të vëllazëruara, Institucione/agjenci për mbështetjen e biznesit, Firma të interesuara për bashkëpunim me nga BE dhe nga rajoni.		institucioneve me qëllim të realizimit të BxB takimeve dhe lidhjes së kontratave konkrete.	
27. Formimi i forumit të biznesit të qytetit		<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Projekti parashikon mbajtjen e takimeve të rregullta të biznesit të prefektit të Qytetit të Shkupit dhe prefektëve të komunave në Qytetin e Shkupit me përfaqësues të biznesit. Organizimi i tribunave tematike do të jetë mundësi që të dëgjohen qëndrimet dhe kërkesat e bashkësisë vendore të biznesit, të përçohen të gjitha informatat e reja dhe të kërkojnë mënyra dhe mundësi për tejkalimin e disa problemeve. <u>Qëllimi:</u> Bashkëpunim i përmirësuar ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe komunave të tjera përkitazi me zhvillimin e NVM dhe sipërmarrësisë <u>Grupet e synuara/bartësit:</u>		-Formohet forum i biznesit me grupe lobimi të definuara të sektorëve -Organizohen 4-6 tribuna -Selektohen ide për projekte të përbashkëta me bashkësinë e biznesit -Nënshkruhen memorandume bashkëpunimi për projektet me interes të përbashkët	

		Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Qytet Institucione për mbështetjen e NVM			
--	--	---	--	--	--

Shtylla 2 –Mësim sipërmarrësie dhe kulturë sipërmarrësie

Цели, мерки и проекти	Vlerësim përfundimtar / P R I O R I T E T I	Përshkrim i shkurtër Qëllimi dhe grupet e synuara /shfrytëzuesit(beneficiary)	Periudha e implementi mit/ korniza kohore/afat et	Rezultatet e pritura	Konstrukc. financiar. (shuma), shpenzimet për resurse të domosdosh me
1. Promovimi i kulturës së sipërmarrësisë	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Kultura sipërmarrëse është kulturë e re e të jetuarit, kulturë e kultivimit të cilësive individuale që e përbëjnë bazën e sipërmarrësisë: kreativitet, iniciativë, përgjegjësi, pavarësi, aftësi për të pranuar rrezikun. Kultura sipërmarrëse mund të ndihmojë në zhvillimin e ekonomisë, veçanërisht vendeve në tranzicion dhe në pozicionimin e tyre më të mirë në përmasa botërore. Projekti përfshin: promovim të tregimeve të suksesshme të sipërmarrësisë si shembuj pozitivë, përfshirjen e grupeve të marginalizuara dhe pakicave etnike, organizimin e ngjarjeve të hapura për promovimin e kulturës sipërmarrëse (hakatone, gara, Java globale e sipërmarrësisë etj.) <u>Qëllimi:</u> Promovimi dhe stimulimi i të menduarit dhe kulturës sipërmarrëse.	Në vazhdimësi deri në 2021	Rritja e numrit të njerëzve-sipërmarrës dhe hapja e suksesshme e bizneseve të reja	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



		<u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Qyteti i Shkupit Odat ekonomike Shogata të NVM			
2. Gara për sipërmarrësi nëpër shkolla fillore dhe të mesme (bursa)	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Nëpërmjet arsimit, kultura sipërmarrëse duhet të jetë e përfshirë në jetën e fëmijëve dhe të rinjve që nga mosha më e hershme. Njëkohësisht, duhet shtuar vetëdija prindërve, bashkësisë dhe institucioneve arsimore se sipërmarrësia është opsion i respektuar në karrierë. Duhet ndryshuar të menduarit që e sheh sipërmarrësinë si bërje e thjeshtë e parave, veprimtari e rrezikshme dhe mënyrë jo e sigurtë e vetëpunësimit. Të mësuarit sipërmarrës fokusohet në aftësimin e njerëzve të rinj me aftësi menaxhimi që do t'u ndihmojnë në jetën vijuese. Mësohen shkathtësi për fitimin e vetërespektit dhe vetëbesimit si dhe shkathtësi për të ekzistuar në botën e jashtme. Theksi më shumë vëhet në pjesën praktike. Zhvillohet aftësia e individit për ta kthyer idenë në aksion. Kjo përfshin kreativitetin, inovacionin, pranimin e rrezikut, por njëherësh edhe aftësinë për të planifikuar dhe menaxhuar projekte në drejtim të realizimit të qëllimeve të shtruuara. Me qëllim të nxitjes së mësimit sipërmarrës të ndahen bursa për pjesëmarrësit më të suksesshëm në garat e organizuara në nivel lokal. <u>Qëllimi:</u> Përfshirja e kulturës sipërmarrëse në programet arsimore me çka fëmijët dhe të rinjtë që nga mosha e hershme do të mund të orientoheshin kah fitimi i diturisë dhe shkathtësive të nevojshme për zhvillimin e biznesit vetjak. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ministria e arsimit dhe shkencës Institucionet e arsimit Mbështetje- Qyteti i Shkupit	Mesi i vitit 2009	Përçimi i kulturës sipërmarrëse te fëmijët dhe të rinjtë përmes programeve arsimore.	

3. Gara për sipërmarrësi në arsimin sipëror	27	Përshkrim i shkurtër: Mësimi i sipërmarrësisë fokusohet në aftësimin e njerëzve të rinj me aftësi menaxhimi të cilët do t'u ndihmojnë gjatë jetës pasuese. Mësohen shkathtësi për të fituar vetërespekt dhe vetëbesim si dhe shkathtësi për të ekzistuar në botën e jashtme. Më shumë theks i vëhet pjesës praktike. Zhvillohet aftësia e individit për ta kthyer idenë në aksion. Kjo përfshin kreativitetin, inovacionin, pranimin e rrezikut, por njëherësh edhe aftësinë për të planifikuar dhe menaxhuar projekte në drejtim të realizimit të qëllimeve të shtruar. Ndarja e bursave për edukim të kulturës sipërmarrëse. Me qëllim të nxitjes së mësimi sipërmarrës dhe kulturës sipërmarrëse, t'u ndahen bursa pjesëmarrësve më të suksesshëm në garat e organizuara në nivel lokal Qëllimi: Vendosja e masave konkrete stimuluese për zbatim praktik të shkathtësive sipërmarrëse dhe ndarja e çmimeve/financave për fillimin e biznesit vetjak për më të mirët. Grupe të synuara/bartës: Ministria e arsimit dhe e shkencës UKEM Institucione të tjera të arsimit të lartë Mbështetje- Qyteti i Shkupit	Mesi i vitit 2009	Numër i shtuar i bizneseve të reja si rezultat i ideve të biznesit të pjesëmarrësve të suksesshëm në garat e organizuara në arsimin e lartë.	
4. Vendosja e partneriteteve të reja ndërmjet institucioneve arsimore dhe industrisë	27	Përshkrim i shkurtër: Në drejtim të përmirësimit dhe krijimit të kuadrit cilësor i cili do t'u përgjigjet nevojave të shoqërisë, nevojitet vendosja e partneriteteve ndërmjet institucioneve të arsimit dhe industrisë dhe industrisë me qëllim të zhvillimit të prodhimeve dhe shërbimeve të reja dhe kryerjes së transferim të diturisë nga rezultatet shkencore dhe hulumtuese në prototip të cilin industria mund ta ripërpunojë deri në nivel të prodhimit me rrezik minimal. Nga njëra anë do të krijoheshin prodhime dhe shërbime me vlerë të shtuar të konsiderueshme, që të ishin konkurruese në tregun ndërkombëtar. Nga ana tjetër,	Fillimi i vitit 2009	Transferi i diturisë nga rezultatet shkencore dhe hulumtuese, zhvillim i prodhimeve dhe shërbimeve të reja.	

		përmes bashkëpunimit me industrinë do të ndikohet edhe në mënyrën e mbajtjes së mësimdhënies dhe përgatitjes së studentëve, për t'i përmirësuar dituritë dhe shkathtësitë e tyre që, gjithsesi, do të rezultojë me konkurrencë të rritur në tregun e punës. <u>Qëllimi:</u> Zhvillimi i prodhimeve dhe shërbimeve të reja dhe kryerja e transferim të diturisë nga rezultatet shkencore e hulumtuese, përmes vendosjes së bashkëpunimit dhe partneriteteve ndërmjet institucioneve të arsimit dhe industrisë. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ministria e arsimit dhe shkencës UKEM Qyteti i Shkupit Odat ekonomike (LOE)			
5. Përmirësimi i kushteve për sipërmarrësi për femrat sipërmarrëse për aftësi më të madhe konkurruese	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Femrat dhe roli i tyre në sipërmarrësi fitojnë aktualitet gjithnjë e më të madh në vendet e zhvilluara ashtu edhe në vendet në tranzicion. Në ekonomitë e zhvilluara ndiqen të gjithë faktorët të cilët mund të kontribuojnë për zhvillimin dhe ata faktorë shfrytëzohet në mënyrë maksimale. Në botë vazhdimisht paraqiten kushte të volitshme për zhvillimin e sipërmarrësisë femërore, përmes fondeve, masave stimuluese për lehtësime dhe lirime, mbështetje të një ekosistemi të ndryshëm për sipërmarrësi, duke i përfshirë femrat dhe shoqërinë civile, me qëllim të rritjes së konkurrencës ekonomisë së Republikës së Maqedonisë. Me projektin parashikohet edhe mbështetja e femrave sipërmarrëse aktuale dhe potenciale përmes përdorimit të shtuar dhe të përmirësuar të teknologjisë, inovacioneve, rrjetëzimit dhe eksportit si dhe ndërtimit të kapacitetit të asociacionit për sipërmarrësi femrash- shoqatës së femrave në biznes dhe Platformave për forcimin e ekosistemit për	Në vazhdimësi deri në 2021	Rritja e numrit të bizneseve të reja të suksesshme nga femrat sipërmarrëse Zhvillimi i bizneseve ekzistuese të femrave sipërmarrëse	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



		sipërmarrësinë në Maqedoni, përmes implementimit të Strategjisë Nacionale e për zhvillimin e SF 2018-2022 në RM. <u>Qëllimi:</u> Nxitje dhe mbështetje e femrave sipërmarrëse aktuale dhe potenciale përmes shfrytëzimit të masave stimuluese për zhvillimin e sipërmarrësisë së femrave dhe përmirësimin e kushteve për zhvillimin e sipërmarrësisë së femrave. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> BE IPA APRM Shoqata e femrave në biznes APSRM			
6. Fushatë informative dhe edukative për dituri financiare	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Përfshirje në sistemin e arsimit të mesëm, në institucionet e arsimit të përgjithshëm si dhe të atij profesional e teknik, si dhe në paketin e shërbimeve për trajnim që sigurohen nga agjencitë e zhvillimit të NVM, me qëllim të diturive të shtuara financiare qytetarëve. Dituria financiare është vegël më e rëndësishme për çdonjërin që a ndër mend të bëhet pronar biznesi ose investues profesional. Dituria financiare është veçanërisht e nevojshme për t'u ndihmuar klientëve që të kuptojnë si të mbrohen nga hyrja në transaksione të cilat financiarisht destruktive. <u>Qëllimi:</u> Bërja e fushatave edukative për rritjen e diturisë financiare, si parakusht kyç për secilin që ka ndër mend të bëhet pronar biznesi ose investues profesional. <u>Grupe të synuara/bartës:</u> Ministria e arsimit dhe shkencës Institucione arsimore	Mesi i vitit 2009	Numër i shtuar i pronarëve të rinj të bizneseve/ investues të cilët kanë hapur biznes të ri të suksesshëm.	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



		Oda ekonomike/shoqata të NVM Mbështetje-Qyteti i Shkupit			
7. Hulumtim për definimin e nevojave të tregut të punës	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Identifikimi i nevojave lokale për fuqi punëtore në drejtim të kënaqjes së nevojave të tregut të punës. <u>Qëllimi:</u> Harmonizim ndërmjet kuadrove të prodhuara nga institucionet arsimore, rikualifikim dhe mbikualifikim adekuat në përputhje me nevojat reale për fuqi punëtore në tregun e punës. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ministria e arsimit dhe shkencës Institucione arsimore Agjenci të punësimit Në bashkëpunim me sektorin e biznesit	Fundi i vitit 2019	Harmonizim ndërmjet kuadrove të prodhuara nga institucionet e arsimit, rikualifikim dhe mbikualifikim adekuat në përputhje me nevojat reale për fuqi punëtore në tregun e punës.	
8. Krijimi i rrjetit të institucioneve për mësim tërëjetësor (rikualifikim dhe mbikualifikim)	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Vendosja e rrjetit të të gjitha institucioneve relevante dhe aktorëve për zbatim efektiv të procesit të rikualifikimit dhe mbikualifikimit të kuadrove, në përputhje me nevojat e tregut. <u>Qëllimi:</u> Forcimi i bashkëpunimit institucional dhe vendosje e rrjetit të institucioneve për mësim efektiv tërëjetësor (rikualifikim dhe mbikualifikim i kuadrit, në përputhje me nevojat e tregut). <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ministria e arsimit dhe shkencës Institucione arsimore Agjenci për punësim Qendra edukative	Fundi i vitit 2019	Rikualifikim dhe mbikualifikim i kuadrit në përputhje me nevojat e tregut.	
9. Përfshirja e sipërmarrësisë në	18	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Zgjerimi i programit arsimor për sipërmarrësi në shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe në sistemin arsimor të	Mesi i vitit 2019	Përçimi i kulturës së sipërmarrësisë te fëmijët dhe të rinjtë	

shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe në sistemin e arsimit të mesëm profesional dhe trajnime adekuate, duke përfshirë trajnimin për sipërmarrësi sociale.		mesëm profesional dhe trajnimit, duke përfshirë trajnimin për sipërmarrësi sociale. Mësimi i sipërmarrësisë fokusohet në aftësimin e njerëzve të rinj me aftësi menaxhimi të cilat do t'u ndihmojnë në jetën pasuese. Mësohen shkathtësi për ta fituar vetërespektin dhe vetëbesimin si dhe shkathtësi për të ekzistuar në botën e jashtme. Theksi vihet më shumë në pjesën praktike. Zhvillohet aftësia individuale për ta shndërruar idenë në aksion. Kjo prfshin kreativitetin, inovacionin dhe marrjen mbi vete të rrezikut, por njëherësh edhe aftësinë për të planifikuar dhe menaxhuar projekte në drejtim të realizimit të qëllimeve të shtruar. Përfshirja e trajnimeve për sipërmarrësi, duke përfshirë edhe trajnime për sipërmarrësi sociale. <u>Qëllimi:</u> Përfshirja e kulturës së sipërmarrësisë në programet e arsimit , me çka fëmijët dhe të rinjtë që nga mosha e hershme do të mund të orientohen kah fitimi i diturisë dhe shkathtësive të nevojshme për zhvillimin e biznesit të vet. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ministria e arsimit dhe shkencës Institucione të arsimit Mbështetja- Qyteti i Shkupit		përmes programeve arsimore	
10. Qendër e sipërmarrësisë (Zhvillimi i frymës sipërmarrëse të të rinjëve- trajnime dhe komisione)	12	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Aktivitetet dhe shërbimet e qendrës janë fokusuar në sigurimin informatave të sakta dhe në kohë dhe ndihmës e mbështetjes së çdo sipërmarrësi përmes realizimit të këtyre aktiviteteve: definimi i masave për përmirësimin e klimës sipërmarrëse në Maqedoni, ndjekja dhe analiza e rezultateve të punës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, mbrojtja e interesave dhe sigurimi i ndihmës teknike për kompanitë-anëtare, bashkëpunim me institucione dhe ministri relevante, bashkëpunim me Qendrën për shkencë, hulumtim dhe edukim dhe me institucione të tjera në organizimin e trajnimit adekuat për sipërmarrës, sigurim i shërbimeve këshilluese.			

		<u>Qëllimi:</u> Krijimi i klimës së volitshme për investim, promovim të zhvillimit të ekonomisë dhe sipërmarrësisë, vende të reja pune dhe rivitalizim të sferave që janë në interes të veçantë shtetëror. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Qyteti i Shkupit Odat ekonomike- Lidhja e odave ekonomike Shërbime konsultimi Fond për inovacione OJQ AMSRM			
11. Trajnime për përmirësimin e shkathtësive për udhëheqje menaxhuese të ndërmarrjeve që janë në pronësi dhe të drejtuara nga persona të rinj	6	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Zhvillimi i programit të trajnimit për përmirësimin e shkathtësive për udhëheqje menaxhuese të ndërmarrjeve që janë në pronësi dhe të drejtuara nga persona të rinj. <u>Qëllimi:</u> Rritja e sukseseve të bizneseve të reja dhe të NVM ekzistuese, të cilat janë në pronësi ose të drejtuara nga persona të rinj. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Qyteti i Shkupit Qendra edukimi Oda ekonomike Shoqata të NVM	Fillimi i vitit 2019	Numër i rritur i hapjes së bizneseve të reja të suksesshme dhe të menaxhuara nga persona të rinj.	
12. Ekip i veçantë ekspertësh i cili do të ofrojë mbështetje konkrete gjatë përgatitjes së aplikacioneve për	4	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Bashkëfinancimi i këshilluesve me qëllim të mbështetjes përkatëse gjatë përgatitjes së dokumentacioneve të nevojshme dhe aplikimeve për projekte dhe instrumenteve financiare. <u>Qëllimi:</u>	Fillimi i vitit 2019	Rritje e numrit të aplikimeve të përkrahura me sukses dhe rritje e shfrytëzimit të instrumenteve financiare.	

projekte dhe instrumenteve financiare		Rritja e suksesit të projekteve dhe përdorimit të instrumenteve financiare. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Qyteti i Shkupit Kompani këshilluese			
13. Punëtori të specializuar dhe trajnime shtesë për sipërmarrësi në Arsimin e lartë.	1	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Përfshirja e punëtorëve përkatëse të specializuara dhe trajnimeve për sipërmarrësi në Arsimin e lartë. <u>Qëllimi:</u> Përfitimi i diturisë së nevojshme dhe shkathtësive konkrete të domosdoshme për sipërmarrësit potencialë dhe për zhvillimin e biznesit vetjak. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ministria e arsimit dhe kulturës Qyteti i Shkupit AMSRM	Mesi i vitit 2009	Rritje e numrit të sipërmarrësve të rinj dhe e realizimit të suksesshëm të bizneseve të reja, si rezultat i pjesëmarrjes në trajnime dhe punëtori të specializuara	
14. Rritje e vetëdijes dhe zhvillim i kulturës sipërmarrëse te mësimeprofesorët, në të gjitha nivelet e arsimit	1	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Zgjerimi i programit arsimor në institucionet arsimore duke përfshirë sipërmarrësin dhe kulturën sipërmarrëse. Zhvillimi i programeve përkatëse për përgatitjen dhe ngritjen e vetëdijes për kulturë sipërmarrësie te arsimtarët/profesorët në të gjitha nivelet e arsimit. <u>Qëllimi:</u> Rritje e vetëdijes dhe zhvillimi i kulturës sipërmarrëse te mësimeprofesorët, në të gjitha nivelet e arsimit. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ministria e arsimit dhe shkencës Qyteti i Shkupit	Mesi i vitit 2009	Rritje e vetëdijes dhe zhvillimi i kulturës sipërmarrëse te mësimeprofesorët, në të gjitha nivelet e arsimit.	

Shtylla– 3 - Inovacionet

Qëllime, masa dhe projekte	Vlerësim përfundimtar / P R I O R I T E T	Përshkrim i shkurtër Qëllimi dhe grupet e synuara /shfrytëzuesit (beneficiary)	Periudha e implementi mit/ korniza kohore/afat et	Rezultatet e pritura	Konstruic. financiar. (shuma), shpenzimet për resurse të domosdosh me
1. Trajnime dhe konsultime të specializuara për rritjen e kapaciteteve të startapeve për veprimtari inovative dhe pjesëmarrje në programet evropiane për hulumtim dhe zhvillim (Horizont 2020 dhe Instrumenti NVM)	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Përmes trajnimeve nga institucione përkatëse dhe njohjes me programet evropiane të hulumtimit dhe zhvillimit, të cilat përmbajnë fusha të shumta për vendosjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit internacional përmes projekteve përkatëse, konferencave, punëtorive të trajnimit, seminareve, forumeve, vizitave studimore e të ngjashme, do të rriten kapacitetet e startapeve në drejtim të përsosmërisë në shkencë, liderizmit në industri dhe përgjigjes së tyre adekuate ndaj sfidave shoqërore. <u>Qëllimi:</u> –Nxitja dhe promovimi i transferit të teknologjive dhe inovacioneve –Mbështetje e hulumtimit dhe zhvillimit teknologjik –Përmirësim i sistemit inovativ në nivel nacional dhe rajonal –Rritje e shkallës së investimeve në teknologji, hulumtime dhe inovacione. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u>	Në vazhdimësi deri në 2021	Shfrytëzim i mundësive të reja afariste të bashkëpunimit Përparim i biznesit të NVM	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



		Start-ape NVM BE IPA fondet: -Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik -Fondacioni për shërbim sipërmarrës për të rinjtë			
2. Data baza e të dhënave për NVM në territorin e Qytetit të Shkupit		<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Krijimi i bazës së të dhënave me informata themelore të biznesit, të cilat do të jenë të disponueshme për opinionin e gjerë dhe për palët e interesuara. Është e nevojshme që të themelohet një trup/entitet me ingjerenca për mbledhjen dhe freskimin e të dhënave ekzistuese dhe vijuese, të cilat do të jenë të rëndësishme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme s dhe për entitetet potenciale të biznesit në treg. <u>Qëllimi:</u> Është lehtësuar qasje në informatat përmes sistemit unik të të dhënave cili do t'i përmbajhtë të gjitha informatat e biznesit. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Start-ape OJQ Qyteti i Shkupit	Mesi i vitit 2009	Përmirësimi i shërbimit për NVM	
3. Zeje të vjetra-mundësi të reja	12	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Me nxitjen e ringjalljes së zejeve të vjetra dhe me rikualifikim dhe mbikualifikim nëpërmjet trajnimeve adekuatë, do të vendosen mundësi të reja për prodhim inovativ, konkurrues dhe kreativ. <u>Qëllimi:</u> Ringjallja e zejeve të vjetra	Mesi i vitit 2019	Zhvillimi i zejeve të vjetra përmes aplikimit të zgjidhjeve inovative	

		<u>Grupet e synuara/bartësit</u> Star-ape Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Qytetarë Agjencia e punësimeve e RM Oda e zejtarëve të Republikës së Maqedonisë			
4. Hapja e laboratorive ose qendrave vendore hulumtuese me teknologji moderne	9	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Laboratori ose qendra vendore hulumtimi që kanë orientim hulumtues për të caktuar nevojat që i kanë NVM. (shembull– nevoja e teknologjisë për të vlerësuar cilësinë e truallit, tokës etj.) <u>Qëllimi:</u> Përcaktimi i saktë i nevojave të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sfidat e pritura dhe ato aktuale me të cilat përballen. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme OJQ Fonde Qyteti i Shkupit	Deri në vitin 2021	Përmirësim i analizës së ambientit	
5. Mbështetja e proceseve të aplikimit të inovacioneve (teknologji të reja dhe zhvillim i prodhimeve dhe shërbimeve të reja)	3	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Me mbështetjen e proceseve për futjen e inovacioneve arrihet kontribut afatgjatë pozitiv për zhvillimin e ekonomisë nacionale, përmirësohet aftësia konkurruese përmes përparimit teknologjik dhe operativ dhe siguri i vendeve të reja të punës; mbështetje e formimit të akceleratorëve afaristë-teknologjikë, subjekte për dhënien e mbështetjes infrastrukture veprimtarisë inovative, me qëllim të akselerimit të sipërmarrësisë përmes mbështetjes së personave fizikë që dëshirojnë të themelojnë kompani si dhe ndërmarrjeve tanimë të themeluara në fazën e tyre fillestare (të cilat ekzistojnë të shumtën 6 vjet) duke siguruar ndihmë edukative. Logjistike dhe financiare.	Në vazhdimësi deri në 2021	Aftësi konkurruese dhe inovacion i rritur, futja e prodhimeve/ shërbimeve të reja nga NVM	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



		<u>Qëllimi:</u> Nxitje dhe mbështetje veprimtarisë inovative, në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesmepër realizim të zhvillimit të shpejtuar teknologjik, të bazuar në përçimin e diturisë, në hulumtimin e zhvillimit dhe inovacioneve që u kontribuojnë krijimit të vendeve të reja të punës dhe rritjes e zhvillimit ekonomik duke e përmirësuar, njëherësh, ambientin e biznesit për zhvillimin e aftësive konkurruese të kompanive. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Persona fizikë që dëshirojnë të themelojnë kompani Star-ape Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Qyteti i Shkupit Fonde Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik BE			
6. Promovimi i inovacioneve dhe sipërmarrësisë tek më të rinjtë	1	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Me promovimin dhe mbështetjen për futjen e inovacioneve arrihet kontribut pozitiv afatgjatë për zhvillimin e ekonomisë nacionale, përmirësohet aftësia konkurruese përmes përparimeve teknologjike dhe operative dhe sigurohet hapje e vendeve të reja të punës. <u>Qëllimi:</u> Njohja e mundësive që i ofron sipërmarrësia, mundësive për realizimin e idesë vetjake të biznesit si dhe futja e zgjidhjeve të reja inovative me qëllim të fundit- krijim i kuadrit që do të jetë i gatshëm t'u përgjigjet sfidave të reja globale dhe shoqërore. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Persona të rinj – sipërmarrës të rinj potencial Agjencia për mbështetjen e sipërmarrësisë Qyteti i Shkupit BE	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Vetëdija e shtuar për përfitimet nga sipërmarrësia dhe kuadro cilësore nga sipërmarrës të rinj.	

7. Nxitja e zhvillimit të shërbimeve prodhimeve të reja me përdorimin e Design Thinking	1	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Design thinking² është metodologji e cila fokusohet në gjetjen e zgjidhjes më efikase, njëherësh edhe kreative të problemeve. Në vete përmban 5 faza: 1. definimi i problemit, 2. hulumtimi, 3. formimi i ideve, 4. prototipi 5. testimi Me qasjen dhe metodën e kështu nxitet të menduarit kreativ në drejtim të zgjidhjes së problemeve dhe sfidave të cilat përballen kompanitë. Shërbimet dhe prodhimet e reja të bazuara në Design thinking do t'u përgjigjen nevojave të NVM. <u>Qëllimi:</u> Mënyra të reja dhe kreative të gjetjes dhe zhvillimit të shërbimeve dhe prodhimeve të reja. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme OJQ Qyteti i Shkupit	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Aplikimi i metodologjisë së re për zhvillimin e shërbimeve dhe prodhimeve të reja	
8. Forcimi i kapaciteteve inovative të të punësuarëve në NVM dhe nxitja e Intrapreneurship në kompanitë		<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Intrapreneurship – Praktika e menaxhmentit korporativ i cili i integron qasjet për ndërmarrjen e rrezikut dhe inovacioneve si dhe teknikave dhe shpërblimit dhe motivimit. Fokusohet në inovacione dhe kreativitet, duke e transformuar idenë në një sipërmarrje fitimprurëse. <u>Qëllimi:</u> Rritja e vetiniciativës së të punësuarëve në organizatat për të ndërmarrë diçka të re, pa u kërkuar kjo prej tyre në mënyrë eksplicite.	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Kuadër cilësor dhe konkurrues	

² <https://www.interaction-design.org/literature/article/5-stages-in-the-design-thinking-process>

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



		<u>Gruet e synuara/bartësit:</u> Fuqia punëtore Ndërmarrje të vogla dhe të mesme OJQ Qyteti i Shkupit			
9. Nxitja e aplikimit të teknologjive moderne në procesin e punës-3D printing, përdorimi i big data, gamification, rones etj. .		<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Teknologjitë moderne gjejnë rol dhe rëndësi gjithnjë e më të madhe në punën e përditshme. Gamification më shpesh përdor elemente të lojës me qëllim të përmirësimit të angazhimit të shfrytëzuesit , produktivitet organizativ, qarkullim më të madh informatash, mësim, riorientim, punësim dhe vlerësim të të punësuarëve, me efekte pozitive ndaj individëve. <u>Qëllimi:</u> Rritje e aftësisë konkurruese dhe inovative <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Fonde OJQ BE Qyteti i Shkupit	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Aftësi konkurruese dhe inovacion i rritur, aplikim i prodhimeve/ shërbimeve të reja nga ana NVM.	
10. Përparimi i veprimtarisë inovative	1	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Si mundësi për përparimin e veprimtarisë inovative janë kurset e ndryshme për zhvillim, udhëzues, materiale dhe aktivitete për stimulimin e veprimtarisë inovative. <u>Qëllimi:</u> Stimulim dhe përparim i veprimtarisë inovative <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	Mesi i vitit 2019	Veprimtari inovative e rritur dhe e përparuar	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



		Fondi i inovacioneve dhe zhvillimit teknologjik OJQ Qyteti i Shkupit			
11. Kurse onlajn për menaxhim inovacionesh	1	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Kursët onlajn për menaxhim inovacionesh, si një prej mjeteve për të përmirësuar konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe do të stimulohen kapacitetet e tyre për marrjen dhe realizimin e projekteve inovative. Si pjesë e kursit është pasqyra e çështjeve me aplikimin e proceseve dhe teknologjisë së re në tregun ekzistues ose funksionin e biznesit. <u>Qëllimi:</u> Krijimi i klimës së fuqishme inovativepërmes promovimit të konceptit të bizneseve inovative. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Fonde Fondacioni për shërbim sipërmarrësie për të rinj, Fondacioni për menaxhim dhe hulumtin industrial BE Qyteti i Shkupit	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Aftësi konkurruese e rritur e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe stimulim për marrjen dhe realizimin e projekteve inovative.	

**Shtylla 4 – Sektori produktiv dhe konkurrues i NVM
(tregu vendor dhe i huaj)**

Qëllime, masa dhe projekte	Vlerësim përfundimtar / P R I O R I T E T	Përshkrim i shkurtër Qëllimi dhe grupet e synuara /shfrytëzuesit (beneficiary)	Periudha e implementi mit/ korniza kohore/afat et	Rezultatet e pritura	Konstruic. financiar. (shuma), shpenzimet për resurse të domosdosh me
1. Financimi i aktiviteteve programore të inkubatorëve të biznesit dhe qendrave për zhvillim të inovacioneve në Qytetin e Shkupit	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Aplikimi i mbështetjes financiare të projekteve për organizimin e trajnimeve dhe shërbimeve këshilluese për biznese të reja dhe mbështetje e aktiviteteve programore të inkubatorëve të biznesit. <u>Qëllimi:</u> Përparim i punës dhe realizim i suksesshëm i aktiviteteve programore të inkubatorëve të biznesit dhe qendrave për zhvillimin e inovacioneve në Qytetin e Shkupit. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Qyteti i Shkupit Inkubatorë biznesi Qendra për zhvillimin e inovacioneve	Mesi i vitit 2019	Realizim i suksesshëm i aktiviteteve programore, trajnimeve dhe shërbimeve këshilluese nga ana e inkubatorëve të biznesit dhe qendrave për zhvillim të inovacioneve	
2. Forcimi i arsimimit digjital të NVM tradicionale dhe nxitja e shfrytëzimit të	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Aplikimi i trajnimeve për arsimim digjital të NVM tradicionale dhe nxitja e shfrytëzimit të mediave sociale për promovim.	Mesi i vitit 2019	Përparimi i biznesit të NVM, përmes rritjes së arsimimit digjital të NVM	

mediave sociale për promovim		Arsimimi digjital do të thotë shumë më tepër se pranim i teknologjive të reja, shfrytëzim i medieve sociale ose krijim dhe ndjekje e fotove dhe videove. Kjo është aftësi për përdorimin e teknologjive digjitale, si mjete për krijimin, selektimin dhe lidhjen e informatave nga më shumë burime, Në formate të shumta dhe përdorimi i tyre për përmirësimin e efektivitetit në cilëndo fushë-mësim, punë etj. Ndonëse testimet formale, të cilat janë zbatuar deri më tash në Maqedoni, tregojnë shkallë të lartë të arsimimit digjital të rinjtë, kjo temë mbetet aktuale për të menduar dhe vepruar në drejtim të përmirësimit të tij. <u>Qëllimi:</u> Rritja e arsimimit digjital të NVM tradicionale dhe nxitja e shfrytëzimit të medieve sociale për promovim, në drejtim të përparimit të biznesit të tyre. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Qyteti i Shkupit Qendra edukimi Ndërmarrje të vogla dhe të mesme		tradicionale dhe shfrytëzim i shtuar i medieve sociale për promovim.	
3. Lidhja e ndërmarrjeve të vendit me ato të huaja në zonat teknologjike-industriale	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Organizimi i ngjarjeve afariste për rrjetëzim dhe këmbim kontaktesh ndërmjet NVM vendore dhe kompanive të huaja në zonat teknologjike- industriale. <u>Qëllimi:</u> Këmbimi i kontakteve në drejtim të rritjes së mundësive për bashkëpunim ndërmjet NVM vendore dhe kompanive të huaja në zonat teknologjike- industriale. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Drejtoria për zona zhvillimore teknologjike- industriale Oda ekonomike Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Kompani të huaja	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Shfrytëzimi i mundësive të reja afariste për bashkëpunim	Përparimi i biznesit të NVM

4. Zhvillim i programeve dhe shërbimeve që do t'u ndihmojnë NVM që të hyjnë në tregjet e huaja	9	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Identifikimi i shkurtër zinxhirëve kryesor ndërkombëtarë të vlerës në të cilët NVM në territorin e Qytetit të Shkupit kanë kapacitete për pjesëmarrje të suksesshme për zhvillim të programeve dhe shërbimeve që do t'u ndihmojnë NVM të hyjnë në këta tregje. <u>Qëllimi:</u> Mbështetje e shtuar për hyrje të NVM në zinxhirët kryesorë ndërkombëtarë të vlerës në tregjet e synuara të huaja. <u>Grupet e synuara/bartësit :</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Qyteti i Shkupit Oda ekonomike/ Shoqata të NVM Kompani këshillimi	Fundi i vitit 2019	Numër i shtuar i NVM të cilat kanë depërtuar në tregjet e huaja Orientim i shtuar kah eksporti i NVM	
5. Aplikimi i masave stimuluese për implementimin edhe certifikimin e standardeve ndërkombëtare ISO për NVM	8	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Aplikimi i programeve konkrete dhe masave stimuluese për implementimin e standardeve ndërkombëtare ISO dhe certifikimin e standardeve ndërkombëtare ISO për NVM. <u>Qëllimi:</u> Përparimi i cilësisë së punës, mbrojtja e ambientit jetësor, shëndet dhe siguri gjatë punës, kursim i energjisë së NVM etj. Përmes standardizimit të të punuarit fitimit të mirënjohjes ndërkombëtare dhe dukshmërisë përmes certifikatat të akredituar. <u>Grupet e synuara/bartësit :</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Qyteti i Shkupit Kompani këshillimi Shtëpi certifikimi	Fundi i vitit 2018	Cilësi e gjithëmbarshme e shtuar e punës së NVM Është rritur njohja e tregut të vendit dhe atij ndërkombëtar Hapje e mundësive të reja për biznes dhe bashkëpunim të NVM	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



6. Nxitje e bujqësisë organike dhe inovative	8	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Aplikimi i programeve konkrete dhe masave stimuluese për nxitjen e bujqësisë organike inovative. <u>Qëllimi:</u> Motivimi i NVM nga sfera e bujqësisë për investim në bujqësi organike dhe inovative. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujrave. Agjencia për mbështetje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Agjencia për nxitjen dhe zhvillimin e bujqësisë Qyteti i Shkupit Kompani këshillimi	Fillimi i vitit 2019	Numër i rritur i investimeve të NVM në bujqësi organike dhe inovative.	
7. Rritja e mbështetjes së politikave të eksportit		<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Aplikim i masave stimuluese për motivimin e hapjes së NVM të reja në veprimtari moderne dhe inovative, të cilat do të jenë, para së gjithash, me orientim nga eksporti. Shfrytëzim i vazhdueshëm i rrjetit të mundësive të biznesit , i cili ka për qëllim t'ua ofrojë të gjitha format e mbështetjes afaristenmdërmarrjeve të vogla dhe të mesme në rrugën e tyre drejt tregjeve evropiane, përmes dhënies së mundësive dhe ndihmës ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për shfrytëzimin e mundësive të ndryshme të biznesit në kuadër të tregut unik të BE, duke zhvilluar aktivitete bashkëpunimi nga sfera e biznesit, teknologjisë ose shkencës. <u>Qëllimi:</u> Mbështetje e shtuar e NVM përmes shfrytëzimit të mundësive të mbështetjes së bizneseve inovative dhe qasjes te financat dhe programet e financimit të Bashkimit Evropian.	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Numër i rritur i NVM të hapura me orientim nga eksporti, në veprimtari bashkëkohore dhe inovative	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



		<u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Qendra informative dhe inovative evropiane në Maqedoni (QIEM) Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup Fondacioni për menaxhim dhe hulumtim industrial, Oda ekonomike e Maqedonisë, Lidhja e odave ekonomike të Maqedonisë.			
8. Zhvillimi i programeve për transferin e diturive, teknologjive, përvojave dhe praktikave të mira nga vendet e zhvilluara		<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Zhvillimi i rrjetëzimit të biznesit (realizim kontaktesh, partneritetesh, forumesh dhe rrjetash për këmbim të përvojave dhe diturisë); organizim i trajnimeve për nevojat specifike; zhvillim i kapaciteteve mentorale dhe programeve mentorale. <u>Qëllimi:</u> Stimulimi i kulturës së sipërmarrësisë dhe këmbimi i praktikave të mira dhe diturisë me NVM nga vende të tjera. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Oda ekonomike Agjenci/ministri	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Përvoja dhe mundësi të fituara pozitive për bashkëpunim të NVM me kompani të vendit dhe të huaja	
9. Sigurimi i trajnimeve cilësore për shitje në tregun ndërkombëtar		<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Organizimi i trajnimeve të specializuara dhe këshillimeve për NVM, përkthazi me teknikat për shitje të suksesshme, posaçërisht në tregun ndërkombëtar. <u>Qëllimi:</u> Rritja e suksesit në realizimin e biznesit, përmes depërtimit cilësor, prezantimit dhe shitjes së prodhimeve/shërbimeve në tregun ndërkombëtar. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Oda ekonomike Kompani këshillimi Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Shtimi i numrit të NVM me biznes të realizuar me sukses në tregun ndërkombëtar.	

10. Nxitja e hapjes së NVM të reja në segmente specifike dhe aplikimi i metodologjisë për shpejtimin e realizimit të biznesit (Lean Startup Methodology)		<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Futja e masave stimuluese për nxitjen e hapjes së NVM të reja me orientim konkret në veprimtari/segmente specifike dhe aplikim i metodologjisë për shpejtimin e realizimit të biznesit (Lean Startup Methodology). <u>Qëllimi:</u> Rritja e numrit të NVM të hapura të reja në veprimtari/segmente specifike. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Qyteti i Shkupit Oda ekonomike Kompani këshillimi			
11. Njohje e NVM me standardet evropiane për cilësinë e shërbimeve/prodhimeve të nevojshme për eksport		<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Aplikimi i programeve konkrete për njohjen e NVM me standardet evropiane të cilësisë së shërbimeve/prodhimeve të nevojshme për eksport. <u>Qëllimi:</u> Rritja e potencialit eksportues të NVM për njohjes së tyre dhe aplikimit të standardeve ndërkombëtare për cilësi. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Qyteti i Shkupit Oda ekonomike/ shoqata të NVM Kompani këshillimi	Fundi i vitit 2018	Rritje e potencialit eksportues të NVM Cilësi e gjithëmbarshme e rritur në punën e NVM Është rritur njohja në tregun e vendit dhe atë ndërkombëtar	

Shtylla – 5 - Financimi

Qëllime, masa dhe projekte	Vlerësim përfundimtar / P R I O R I T E T	Përshkrim i shkurtër Qëllimi dhe grupet e synuara /shfrytëzuesit (beneficiary)	Periodha e implementi mit/ korniza kohore/afat et	Rezultatet e pritura	Konstruic. financiar. (shuma), shpenzimet për resurse të domosdosh me
1.Mbështetje e sipërmarrësisë kreative	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Nxitja e sipërmarrësisë kreative, përmes trajnimeve, fushatave promovuese dhe mjeteve me të cilat krijohet mjedis në të cilin nxitet kreativiteti, veçanërisht te popullata e re për zhvillimin e mjeteve në bashkësitë vendore si dhe shkathtësive sipërmarrëse për lirin e potencialit në industritë kreative. <u>Qëllimi:</u> Ambienti kreativ dhe inovativ <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Njerëz të rinj me orientim kreativ dhe shkathtësi Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Agjencia për mbështetjen e sipërmarrësisë Qyteti i Shkupit	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Ambient kreativ dhe inovativ me kapacitet të lartë sipërmarrës	
2. Ndarja e çmimit për eksportuesin më të Qytetit të Shkupit	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Dhënia e çmimit eksportuesit më të mirë ka për qëllim të stimulohen ndërmarrje të reja eksportuese të kompanive të vendit. Çmimi përmban edhe të drejtën ekskluzive të kompanive të	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Rritja e inovacionit, eksportit dhe aftësisë konkurruese të kompanive të vendit	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



		shpërblyera në materialet e veta ta përdorin logon “eksportues i vitit” <u>Qëllimi:</u> Stimulimi i investimeve dhe i eksportit. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Agjencia për investime të huaja dhe promovimi i eksportit të RM Qyteti i Shkupit			
3. Fond shtesë që do të sigurojë mbështetje gjatë përgatitjes së aplikacioneve për Fondin e inovacioneve dhe zhvillimit teknologjik	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Vendosja e fondit shtesë Për bashkëfinancimin e këshilluesve me qëllim të përkrahjes adekuate gjatë përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm dhe aplikacioneve për Fondin e inovacioneve dhe zhvillimit teknologjik. <u>Qëllimi:</u> Shtimi i projekteve të suksesshme dhe shfrytëzimit të mjeteve të Fondit për inovacione dhe zhvillim teknologjik. <u>Grupet e synuara/bartësit :</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik Qyteti i Shkupit Kompani këshillimi	Fillimi i vitit 2019	Rritja e numrit të aplikacioneve të miratuara, të suksesshme, dhe rritja e shfrytëzimit të mjeteve financiare nga Fondi i inovacioneve dhe zhvillimit teknologjik	
4. Zvogëlimi i taksës për firmë për ndërmarrjet me, të paktën, 5 të punësuar	27	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Përmes zvogëlimit të taksës për firma të ndërmarrjeve me të paktën 5 të punësuar, nxitet fillimi i biznesit vetjak si dhe aftësia konkurruese e ndërmarrjeve ekzistuese. Në këtë mënyrë vetë ndërmarrjet do të nxiten për përmbushjen e detyrimit të vet për taksën e firmës dhe do të shmangen vështirësitë eventuale për ta paguar detyrimin e vet.	Viti 2018.- Në vazhdimësi deri në vitin 2021.	Shpenzime të zvogëluara për taksës për firmë dhe nxitja e fillimit të biznesit individual	

		<u>Qëllimi:</u> Zvogëlimi i shpenzimeve gjatë punës së ndërmarrjeve mikro dhe të vogla dhe nxitja e fillimit të biznesit. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje mikro dhe të vogla Start-upet Qyteti i Shkupit			
5. Vendosja e instrumenteve të reja për zhvillimin NVM	18	<u>Краток опис:</u> Përmes instrumenteve të reja financiare (si crowdfunding) mundësohet zhvillimi dhe mbështetja gjatë formimi dhe punës së NVM, me çka do t'u lehtësohet puna dhe qasja deri te financimi- që është një prej sfidave më të mëdha me të cilën përballen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. <u>Qëllimi:</u> Mbështetja dhe zhvillimi i NVM <u>Gruoet e synuara/bartësit:</u> NVM Ministria e financave Qyteti i Shkupit	2019 dhe në vazhdimësi	Aplikimi i praktikave evropiane të financimit alternativ dhe mbështetje më e madhe NVM-ve	
6. Ndhimë gjatë formimit të prodhimit konkurrues në tregun e vendit dhe të jashtëm	18	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Zhvillimi dhe aplikimi i programeve dhe shërbimeve që do t'u ndihmojnë NVM të formojnë prodhim/shërbim konkurrues në tregun e brendshëm dhe të depërtojnë në tregun e jashtëm. <u>Qëllimi:</u> Mbështetje e shtuar e NVM që të formojnë prodhim/shërbim konkurrues në tregun e brendshëm dhe të depërtojnë në tregun e jashtëm. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u>	Fundi i vitit 2019	Numër i rritur i NVM të cilat kanë depërtuar në tregun e vendit dhe në aaë të huajat. Rritje e orientimit kah eksporti i NVM	

		Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Qyteti i Shkupit Oda ekonomike/Shoqata të NVM Kompani këshillimi			
7. Ndarja e çmimeve financiare për projektin më të suksesshëm nga sfera e sipërmarrësisë sociale	12	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Sipërmarrësia sociale luan rol të rëndësishëm në sfidat sociale, ekonomike dhe ekologjike e njëherësh siguron rritje inkluzive për prosperitet të përbashkët dhe inkluzion social. Aplikimi i çmimeve financiare për projekte më të suksesshme nga sfera e sipërmarrësisë sociale <u>Qëllimi:</u> Motivimi i NVM që të orientohen kah sipërmarrësia sociale, me çka do të sigurohet rritje inkluzive për prosperitet të përbashkët dhe inkluzion social. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ministria e punës dhe e politikës sociale Programet e financimit nga ana e Bashkimit Evropian Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Institucione qeveritare dhe joqeveritare	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Vende të reja pune për persona të marginalizuar dhe për persona në rrezik social	
8. Ndarja e çmimeve për ndërmarrjen më me përgjegjësi shoqërore	12	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Ndjekje e vazhdueshme e kontributit dhe përgjegjësisë shoqërore të NVM dhe ndarja e çmimeve për ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore. <u>Qëllimi:</u> Motivimi i NVM drejt realizimit të aktiviteteve që janë me përgjegjësi shoqërore. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u>	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Kontribut i shtuar shoqëror nga ana e NVM	

		Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Ministria e ekonomisë- trupi koordinues për përgjegjësi shoqërore të ndërmarrjeve Qyteti i Shkupit			
9. Zhvillim i vazhdueshëm i tregut të formave të reja alternative të financimit	9	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Zhvillim i formave të reja të financimit të NVM, veçanërisht në fillim të themelimit të tyre, përmes tërheqjes së kapitalistëve venture, ëngjuve të biznesit, crowd funding, themelimit të fondit investues për deponim në bizneset start-up dhe në NVM. <u>Qëllimi:</u> Vendosje e sistemit të informimit dhe mbështetjes së NVM për format alternative të financimit, me të cilat do t'u mundësohet investim dhe realizim të idesë së tyre të biznesit. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Ministria e financave Rrjeti evropian i mundësive të biznesit Fondacioni i menaxhmentit dhe hulumtimit industrial Oda ekonomike/Shoqata të NVM	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Mundësi të shtuara për shfrytëzimin e burimeve alternative të financimit të NVM të reja Numër i shtuar i NVM të hapura me sukses të cilat kanë depërtuar dhe kanë qëndruar në treg	
10. Ekspertiza për qasje në financat përmes fondeve nacionale dhe evropiane	9	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Ekspertizë nëpërmjet projekteve adekuate, konferencave, punëtorive të trajnimeve, seminareve, forumeve, vizitave studimore, në drejtim të rritjes së qasjes në financat e fondeve nacionale dhe evropiane. <u>Qëllimi:</u> Informim më i madh dhe mbështetje e NVM për qasje dhe shfrytëzim të mjeteve financiare nga fondet e disponueshme nacionale dhe evropiane. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Shfrytëzim më i madh i mjeteve financiare nga fondet nacionale dhe evropiane	

		Institucione financiare të vendit Fonde evropiane Oda ekonomike/shoqata të NVM Kompani këshillimi			
11. Vendosje e linjës mikro-kreditore për mbështetje të kompanive start-ap dhe mikro	4	<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Vendosja e linjës mikro kreditore për mbështetjen e kompanive start-ap dhe mikro, veçanërisht në fillim të themelimit të tyre. <u>Qëllimi:</u> Rritja e suksesit dhe e mbijetimit të NVM, përmes vendosjes së linjës mikrokreditore për mbështetjen e kompanive start-ap dhe mikro. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mëdha Ministria e financave Bankat ekonomike Oda ekonomike/shoqata të NVM	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Mundësi të shtuara për financimin e NVM të reja Numër i shtuar i NVM të hapura me sukses të cilat kanë depërtuar dhe kanë qëndruar në treg	
12. Përgatitje e listës së ekspertëve për mbështetje gjatë qasjes në financat		<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Përgatitja e listës së ekspertëve për mbështetje të NVM gjatë qasjes në financat. Bashkëfinancimi i konsultuesve me qëllim të mbështetjes adekuate gjatë përgatitjes së dokumentacioneve të nevojshme dhe aplikacioneve për projekte dhe instrumenteve financiare, zbatimin e stërvitjeve përkatëse, seminareve, trajnimeve etj. <u>Qëllimi:</u> Suksesi i rritur i projekteve dhe shfrytëzimit të instrumenteve financiare. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Qyteti i Shkupit	Fillimi i vitit 2019	Rritje e numrit të aplikacioneve të aprovuara me sukses dhe rritja e shfrytëzimit të instrumenteve financiare	

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



		Kompani këshillimi Oda ekonomike			
13. Subvencione shtesë ose stimulime nga pushteti vendor gjatë daljes në tregun nacional dhe ndërkombëtar		<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Subvencione dhe stimulime me të cilat NVM do të mund të sigurojnë paraqitje konkurruese në tregun ndërkombëtar me shpenzime më të vogla si dhe shpërndarje të duhur dhe shitje/eksport në vendet e tjera. <u>Qëllimi:</u> Pozicionimi konkurrues i NVM në tregun ndërkombëtar. <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Fondacione, Fonde Qyteti i Shkupit	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Prafitje konkurruese e NVM dhe dalje në tregun ndërkombëtar	
14. Subvencione shtesë nga pushteti vendor për çdo ndërmarrje të zhvilluar në aspektin social		<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Me subvencionet shtesë për çdo ndërmarrje sociale nxitet zhvillimi i sipërmarrësisë sociale, me çka plotësohet nevoja për inkluzion të të gjitha grupeve shoqërore- duke përfshirë edhe grupet në rrezik, me pozicionimin e bizneseve si bartës të aktorëve shoqërorë e jo vetëm ekonomikë. <u>Qëllimi:</u> Nxitja e sipërmarrësisë sociale <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Fondacione, Fonde Qyteti i Shkupit	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Sipërmarrësi e zhvilluar sociale	
15. Promovimi dhe njohja me konceptet e crowdsourcing/ crowdfunding		<u>Përshkrim i shkurtër:</u> Konceptet e - Crowdsourcing (praktikë e angazhimit të një grupi të personave fizikë ose juridikë për realizimin e qëllimit	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Promovim i koncepteve të reja dhe aplikim i praktikave evropiane të financimit alternativ	

		të përbashkët- inovacionit, zgjidhjes së problemeve ose efikasitetit.) ³ dhe - Crowdfunding (praktika e financimit të një projekti me marrjen e një shume të vogël të parave nga ana e një numri të madh njerëzish, rëndom përmes Internetit.) ⁴ janë mënyra të reja financimi që marrin hov të madh në Evropë dhe në botë. Duke u njoftuar me këta koncepte të reja, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe start-apet do të njoftohen me mundësitë alternative të financimit për të zhvilluar biznesin e vet.. <u>Qëllimi:</u> Promovimi dhe njohja e modeleve të reja bashkëkohore të mënyrave alternative të financimit <u>Grupet e synuara/bartësit:</u> Ndërmarrje të vogla dhe të mesme Start-ape OJQ Qyteti i Shkupit			
--	--	---	--	--	--

³ <https://crowdsourcingweek.com/what-is-crowdsourcing/>

⁴ <https://crowdsourcingweek.com/blog/what-is-crowdfunding/>

Shtojca 1 – Pjesëmarrësit e procesit

	Pjesëmarrës	Personi për kontakt
	Qyteti i Shkupit dhe komunat e qytetit	
1.	Qyteti i Shkupit – kabineti i prefektit	Marko Todorov, Toni Macevski
2.	Qyteti i Shkupit – sektori i zhvillimit ekonomik vendor	Sillobodan Qosev, Daniella Trimçevska, Snezhana Todevska, Rebeka R. Stanoevska
3.	Komisioni për zhvillim ekonomik vendor i Qytetit të Shkupit	Sonja Glinçarska, Svetlana Kollariq
4.	Qyteti i Shkupit – sektori i arsimit	Biljana Paunovska
5.	Qyteti i Shkupit – sektori i çështjeve komunale	Hristina Tripunovska
6.	Qyteti i Shkupit – sektori i ambientit jetësor	Aleksandra Dimitrievska
7.	Qyteti i Shkupit – sektori i komunikacionit	Mile Boshkovski
8.	Qyteti i Shkupit – sektori i kulturës	Shukran Sali
9.	Qyteti i Shkupit – sektori i planifikimit dhe rregullimit të hapësirës	Aleksandar Janakievski
10.	Qyteti i Shkupit – sektori i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe OJQ	Sasho Mitrov
11.	Komuna Qendër	Emir Qoriq, Ivana Spasovska, Ivan Minovski, Anastazija Babullovskaja
12.	Komuna Karposh	Robert Janovski, Maja Filipçeva, Aleksandra Teova
13.	Komuna Gazi Babë	Sasho Trajkov
14.	Komuna Gjorçe Petrov	Sasho Maksimovski, Vaska Tërpkovska, Borjana Mitrevska
15.	Komuna Kisella Voda	Pavlina Ribarska, Katerina Siljanoska
16.	Komuna Aerodrom	Vlladimir Stevkov, Dana Gapkovska
17.	Komuna Shuto Orizari	Erhan Fejzov
18.	Komuna Butel	Ivana Rajčinova, Irena
19.	Komuna Çair	Sonja Gjorgjievskaja
20.	Komuna Saraj	Bajram Duraku, Fari Rexhepi
	Ministri dhe institucione të tjera në nivel qendror	
21.	Ministria e ekonomisë	Blerim Zlatku, Suzana Arsova –Kostadinovska

Strategjia për NVM dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për 2018-2021



Ndërmarrje të vogla dhe të mesme, përkatësisht shoqata, asociacione, oda, fondacione, OJQ		
22.	Lidhja e odave ekonomike të Maqedonisë	Maja Savevska
23.	Oda ekonomike e Maqedonisë	
24.	Oda e zejtarëve të Republiës së Maqedonisë	Snezhana Dankovska
25.	Oda e zejtarëve të Shkupit	Snezhana Dankovska
26.	Organizata e punëdhënësve të Maqedonisë	
27.	Fondacioni për zhvillimin e NVM	Svetllana Kirevska
28.	Fondacioni për menaxhment dhe hulumtim industrial	
29.	Fondacioni PSM –YES inkubator	Olivera
30.	Qendra nacionale e inovacioneve	Tamara Çolloviq
31.	Qendra për menaxhimin e ndryshimeve	Martin Todevski
32.	Shoqata e qytetarëve- Qendra për zhvillim rural	
33.	Shoqata për nanomateriale dhe nanoteknologji NANOMAK	
34.	Shoqata CELOR – qendra për zhvillim lokal	
35.	Shoqata e qytetarëve për përparimin e zejtarisë artistike dhe artizanatit – MATA	Vesna Avramovska
36.	Instituti për zhvillim të qëndrueshëm rural rajonal BELA VISTA- IORRR	Sasho Matovski
37.	Qendra e hulumtimit dhe krijimit të politikave- CIKL	
38.	Shoqata e vullnetarizmit- Qendra vullnetariste	
39.	Legurat e Shkupit (Skopski leguri)	Goran Mitevski
40.	Skopje Lab	Sofija Bogeve
41.	Mako Market	
Institucione arsimore dhe shkencore		
42.	Instituti ekonomik	

Dispozita përfundimtare

Strategjia për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe për sipërmarrësi e Qytetit të Shkupit me plan të aksionit, për periudhën e viteve 2018-2021, hyn në fuqi me ditën e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Qytetit të Shkupit”.